



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 451/1 Prot.

Tiranë, më 18.03.2024

V E N D I M

Nr. 67, Datë 18.03.2024

Bazuar në nenin 32/1/a, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (në vijim Komisioneri) mori në shqyrtim ankesën nr. 169, datë 15.09.2023, të shtetasit M. H, i cili pretendon diskriminimin e djalit të tij O. H, nga Gjimnazi “Aleks Buda”, Tiranë, për shkak “aftësisë së kufizuar”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, pretendon se, djali ka qenë i regjistruar fillimisht në shkollën 9- vjeçare “Dhora Leka” dhe nuk ka patur asnjë problem. Më pas e ka regjistruar në Gjimnazin “Aleks Buda”, Tiranë vetëm me urdhër të Zyrës Vendore Arsimore. Ankuesi pretendon që në ditën e parë në këtë gjimnaz nuk janë marrë parasysh të drejtat që rrjedhin nga Konventa Ndërkombtare për të Drejtat e Fëmijëve me aftësi të kufizuar. Nuk janë zbatuar programet e posaçme për këto persona, ngelet në klasë pa dëshirën ose pa miratimin e prindërit të fëmijës. Nuk është marrë asnjë rrethanë lehtësuese vetëm që ky fëmijë të largohet nga shkolla.

Fëmija është me sidromën down dhe në këtë gjimnaz nuk ka program që t’i përshtatet fëmijës. Nga gjimnazi ankuesi është informuar që me 45 mungesa nxënësi ngelet ose përjashtohet, gjë të cilën e ka kundërshtuar, pasi këta fëmijë nuk mund të kenë të njëjtin trajtim me fëmijët e tjerë. Mësues të ndryshëm e kanë pyetur ankuesin, përse e sjellë në shkollë apo vetëm që ta heqësh nga shtëpia, duke i thënë që djalin në shkollë e mbajnë vetëm për humanizëm.

Në shkollë, në vazhdimësi fëmijës i janë bërë teste me shkrim në kundërshtim me nevojat e fëmijës, por mësuesja kujdestare në fillim është shprehur që e vlerëson dhe i vendos notat që

meriton pasi ai ka programin “PEI” të veçantë. Ankuesi pretendon që nuk ka marrë pjesë në miratimin e tij, nuk është thirrur asnjëherë që të diskutojë me mësuesit që fëmija mund të ngelet dhe në klasë. Vetëm në datë 13-14 shtator është thirrur nga Drejtoresha dhe në prezencë të mësuesve është informuar se djali është ngelës në 6 lëndë, përfshirë dhe lëndën e frengjishtes, nuk shkruan dhe nuk flet. Në dijëni të ankuesit në programin “PEI” përfshihet dhe gjuha frengjisht.

Ndërkohë djali rezulton se ka ngelur në lëndët që ka frekuentuar fizikisht dhe ka kaluar në lëndët që nuk ka marrë pjesë, pasi djalin e ka marrë çdo ditë në orën 11 nga shkolla, pasi kështu kishte rënë dakort me mësuesin ndihmës. Asnjëherë nuk i është thënë ose sugjeruar se çfarë duhet të bëjë me djalin që nuk mëson. Për djalin nga shokët nuk ka patur asnjë ankesë, por dhe ata si prindër nuk kanë patur asnjë problem nga nxënësit e tjerë.

Në lidhje me këtë çështje ankuesi i është drejtuar Zyrës Vendore Arsimore (ZVA) dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), por ka marrë përgjigje vetëm nga ZVA, ndërsa MAS nuk i ka kthyer përgjigje. Si prindër ata dëshirojnë që djali të vazhdojë shkollën dhe pse nuk do Drejtoresha, pa e ditur arsyen pse nuk dëshiron të vazhdojë shkollën si përsëritës, por as klasën e XI. Arsye e vetme është që t’u largojnë djalin nga shkolla dhe pa shpjeguar arsyen.

Në këtë kuptim, ankuesi kërkon nga Komisioneri:

- të konstatojë situatën diskriminuese për shkak të aftësisë së kufizuar të djalit të tij;
- marrjen e masave për të ndrequr situatën diskriminuese nëpërmjet zbatimit të të drejtave që rrjedhin nga Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar, trajtimin në shkollë njëloj si të tjerët dhe këta fëmijë të mos ngelin në klasë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga

shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.1008/1 prot, datë 21.09.2023, Komisioneri kërkoi informacion nga Gjimnazi “Aleks Buda”, ZVAP Tiranë, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës (DRAP Durrës), Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP), MAS, në lidhje me ankesën e mësipërme.
2. Me shkresën nr.1008/2 prot., datë 19.10.2023, Komisioneri ka rikujtuar institucionet të dërgojnë informacionin e kërkuar me shkresën nr.1008/1 prot, datë 21.09.2023.
3. Me shkresën nr.5994 prot., datë 23.10.2023, ZVAP Tiranë, ka kthyer përgjigje duke vendosur në dispozicion dokumentacionin për nxënësin O.H, por nuk ka dhënë shpjegime në lidhje me ankesën.
4. Me shkresën nr. 5678/7 datë 23.10.2023, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, është dhënë informacioni se nxënësi është regjistruar për vazhdimin e vitit mësimor 2023-2024, në gjimnazin me kohë të pjesshme “Kostandin Kristoforidhi” dhe është përcjellë e gjithë dosja e nxënësit O. H, administruar pranë Komisionerit me nr.1154 prot., datë 24.10.2023.
5. Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, me shkresën nr. 54, datë 26.09.2023 Gjimnazi “Aleks Buda”, ka kthyer përgjigje dhe ka dërguar dosjen e nxënësit O. H, duke parashtruar pretendimet në lidhje me çështjen si më poshtë:

Nxënësi O. H, u regjistrua në klasën e 10-të pranë gjimnazit tonë në vitin shkollor 2022- 2023, me shkresë të ZVAP Tiranë, edhe pse ai kishte mbushur moshën 19 vjeç në korrik 2022. Pretendimi i prindit se djali ka qenë 14 vjeç kur ka kërkuar regjistrimin e tij në gjimnaz, nuk qëndron. Bashkëlidhur keni shkresën e ZVA si dhe certifikatën e nxënësit që vërteton moshën e tij 19 vjeç dhe jo 14 vjeç si e shkruan prindi. Për vitin shkollor 2023-2024, pranimi i O, në klasën e 10- të nuk mund të bëhet, pasi Ligji nr. 69/2012, për sistemin arsimor parauniversitar përcakton kufirin e regjistrimit në klasën e 10-të deri në moshën 18 vjeç dhe mbarimin e AML-së brenda moshës 21 vjeç (Pika 2 e nenit 23 e ligjit nr. 69/2012: Në klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë me kohë të plotë pranohen nxënës të moshës jo më të madhe se tetëmbëdhjetë vjeç), ligji nuk bën përjashtim për fëmijët me AK apo për çfarëdo arsyeje tjetër.

Mësuesja ndihmëse ka hartuar planin edukativ individual (në vijim PEI) në bashkëpunim me mësuesit lëndorë dhe është firmosur edhe nga prindi. PEI, sipas periudhave, përfshin rezultatet minimale të nxënësit në përshtatje me nivelin e nxënësit. Nuk ka pasur asnjë kontestim nga mësuesja ndihmëse dhe as nga prindi, pasi mësuesja ndihmëse e ka hartuar vetë PEI në bashkëpunim me mësuesit dhe prindi i ka firmosur të 3 PEI sipas periudhave mësimore të vitit mësimor. Bashkëlidhur keni 3 PEI sipas 3 periudhave të firmosura nga prindi.

Vlerësimi i nxënësve bazohet në Udhëzimin e MAS nr.17, datë 05.07.2022 “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”. Në nenin 10 të këtij udhëzimi, “Vlerësimi i nxënësve me aftësi të kufizuara”, në pika 1 thuhet: “Vlerësimi i nxënësve me aftësi të kufizuara (AK) për nxënësit që punojnë me Plan Edukativ Individual (PEI) të bëhet bazuar në rezultatet e të nxënësve të përcaktuara në PEI sipas rubrikave të këtij plani, i ndarë në periudha”.

Pra siç del shumë qartë, fjala “Të bëhet” është formë urdhërore e shprehur me mënyrën lidhore të foljes. Udhëzimi e përcakton qartë si bëhet vlerësimi i nxënësve me AK dhe nuk lë hapësira për keqinterpretim. Gjithashtu, ju sjellini në vëmendje se jo pak nxënës me AK që nuk i dalin për zot testit, mbeten dhe në provimet e Maturës Shtetërore. Shkolla jonë nuk ka bërë asgjë më shumë sesa ka zbatuar udhëzimin për vlerësimin e nxënësve me AK. Pas çdo periudhe komisioni i shkollës për nxënësit me AK është mbledhur dhe ka bërë vlerësimin e tij sipas rregullores dhe e ka dërguar edhe në ZVA. Bashkëlidhur keni procesverbalet për vlerësimin e nxënësve. Asnjëherë nuk është diskutuar për përjashtimin për mungesa të nxënësit O. H. Është një shpifje shumë e ulët të cilën e hedh poshtë fakti që, pavarësisht mungesave, kurrë nuk është menduar apo tentuar përjashtimi i tij. Si drejtoreshë e gjimnazit, asnjëherë shkolla nuk i ka numëruar mungesat e tij, asnjëherë nuk kam firmosur “Paralajmërim për përjashtim nga shkolla “për arsye të mungesave dhe asnjëherë nuk i janë kërkuar prindit raporte apo justifikime të mungesave të djalit. Kjo vërtetohet fare lehtë nga mësuesja kujdestare si dhe nëndrejtoresha e shkollës sepse ka një procedurë deri sa të vijë tek drejtori i shkollës për përjashtim. Testimet e fëmijës janë bërë në përfundim të periudhave sepse është kërkesë e udhëzimit për vlerësimin e nxënësve dhe është detyrim ligjor i mësuesve për çdo nxënës në të gjitha shkollat e zakonshme të Republikës së Shqipërisë dhe nuk i janë bërë vetëm nxënësit në fjalë. Testet kanë qënë në përputhje me rezultateve e pritshme të të nxënësve të PEI të hartuara nga mësuesja ndihmëse dhe të miratuara me firmë nga prindi.

Mësuesja ndihmëse nuk ka paraqitur asnjë pretendim apo ankesë për nivelin e testeve të paraqitura sipas periudhave. Nëse prindi ose mësuesja do kishin kontestuar, mësuesit do të kishin rishikuar testet. Prindi është njohur me rezultatet e djalit të tij pas çdo periudhe nëpërmjet sistemit SMIP ku prindi hyn nëpërmes portalit e-albania. Edhe pretendimi se prindi nuk është njohur me notat e fëmijës të tij nuk qëndron. Gjejmë rastin të theksojmë se prindi i O, është me arsim të lartë dhe i aftë për të përdorur sistemet digjitale e-Albania dhe SMIP. Përderisa prindi i referohet lëndës sime frëngjisht, ju bëj me dije se 2 pyetjet e testit për rezultatet e të nxënësve kanë qënë minimale në ekstrem dhe nxënësi nuk ka realizuar asnjërin nga 2 rezultatet e të nxënësve të planit PEI.

Nuk qëndron aspak pretendimi i prindit që vetëm me datën 13-14 shtator është thirrur nga drejtoresha dhe është njoftuar për mbetjen në 6 lëndë. Kemi shumë takime me prindin ku kemi diskutuar edhe me orë të tëra për nxënësin, ku kemi parashtruar mendimet tona, ku kemi kërkuar nga prindi dhe mësuesja ndihmëse bashkëpunim por bashkëpunimi nga prindi ka munguar totalisht. Ai është njohur me notat e djalit në SMIP për të 3 periudhat dhe në përfundim të vitit shkollor kemi

organizuar takim me prindin për ta informuar për mbetjen në klasë. Takimi ka qënë në prezencën e drejtorisë, prindit, mësuesve, oficeres së sigurisë dhe psikologes. Takimi ka qënë me datën 21.06.2023 dhe jo me 13-14 shtator dhe është njoftuar se nxënësi ka mbetur në 6 lëndë dhe ka humbur vitin pavarësisht se prindi ka qënë në dijeni gjithmonë për nivelin dhe rezultatet e tij. Nëse prindi nuk do të ishte informuar në kohën e duhur, ku u bazua për t'u ankuar në ZVA në qershor 2023?

Mësuesit e kanë sqaruar sipas lëndëve se përse nxënësi rezulton mbetës. Prindi ka deklaruar, dhe jo vetëm në këtë mbledhje por në të gjitha takimet e zhvilluara me ne, se “unë e di që djali im nuk mëson, nuk mundet të mësojë por e kam sjellë për socializim”. Ju mund t'i kërkonti atij regjistrimin e të gjithë mbledhjes dhe ta dëgjoni edhe vetë se si është zhvilluar ajo. Prindi, në fund të mbledhjes, ka deklaruar se na ka regjistruar dhe se do ankohej se pse ka mbetur nxënësi në klasë. Mësuesit e kanë pyetur prindin se çfarë është në gjendje të bëjë nxënësi por jemi përballur me sarkazmën e tij. Vërtet ka mësues që e kanë kaluar pa qënë prezent në orën e mësimit por e kanë vlerësuar fiktivisht.

Prindi është ankuar në ZVA për shkollën dhe ZVA me shkresën nr. 2871/I, datë 04.09.2023 ka ngritur pretendime të pabazuara në ligj dhe unë kam shkruar observacionet e mia. Bashkëngjitur keni observacionet e mia me shkresën nr.9, datë 07.09.2023 “Observacion për shkresën me nr. 2871/I, datë 04.09.2023 “Kthim përgjigje Z. M. H, kontakt 0682191056”.

Nuk qëndron aspak pretendimi i prindërit se unë nuk e kam regjistruar nxënësin si përsëritës po në kl.10-të sepse nuk dëshirokam unë. Duke qënë se ligji 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, nuk lejon regjistrimin në klasën e 10-të mbi 18 vjeç dhe duke marrë parasysh faktin se do përballesha me prindin, unë i kam dërguar MAS emailin e mëposhtëm: “I nderuar z. Drejtor! Nxenësi O. H, me aftësi të kufizuara, datëlindje 05.07.2003, nuk ka realizuar asnjë objektiv të Planit Edukativ Individual dhe rezulton mbetës për klasën e 10 në vitin shkollor 2022-2023. Si duhet të veprojmë në këtë rast? A duhet ta regjistrojmë pasi nxënësi e ka tejkaluar moshën për klasën e 10-të. Theksoj se edhe në Udhëzimin e përbashkët për fillimin e vitit shkollor, theksohet se duhet respektuar moshën për regjistrimin e nxënësve. Vitin e kaluar, ky nxënësi është regjistruar bazuar në shkresën e ardhur nga ZVA. Kam marrë përgjigjen si më poshtë : Përshëndetje znj. Bujupi,

Nga sa shkruani, nxënësi O. H, ka mbushur moshën 20 vjeç në korrik 2023. Pranimi i tij në klasën e 10-të nuk mund të bëhet, pasi ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, përcakton kufirin e regjistrimit në klasën e 10-të deri në moshën 18 vjeç dhe mbarimin e AML-së brenda moshës 21 vjeç. (Pika 2 e nenit 23 e ligjit nr. 69/2012: Në klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë me kohë të plotë pranohen nxënës të moshës jo më të madhe se tetëmbëdhjetë vjeç). Ky nxënësi gëzon të drejtën për t'u regjistruar në gjimnazin me kohë të pjesshme.

Prindi nuk është i sinqertë kur thotë se nuk e di arsyen se pse djali nuk është regjistruar në klasën e 10-të si përsëritës në moshën 20 vjeç në klasë me nxënësi të moshës 15 vjeç. Sepse ai më ka paraqitur

kërkesën e tij për sqarim dhe unë i kam dhënë përgjigje me shkrim. Bashkëlidhur keni kërkesën e prindin si dhe përgjigjen time drejtuar atij.

Është shumë e rëndë akuza e prindin për diskriminim ndaj fëmijës tij. E kam lexuar me shumë vëmendje dhe, në asnjë germë të ligjit “Për Mbrojen nga Diskriminimi” nuk ka lidhje me shkollën por ka me dhjetra fakte të cilat e hedhin poshtë këtë akuzë të rëndë si një goditje e turpshme. Shkolla ka bërë gjithçka që nxënësit të ndjehen mire në shkollë. Në shkollë asnjë nxënës me AK, apo tjetër, nuk është ndjerë i diskriminuar për asnjë moment dhe për asnjë arsye.

Ju bëjmë me dije se:

Shkolla ka pasur nxënës me AK të tjerë të cilët me ndihmën e stafit, mësuesit ndihmës, shërbimit psikosocial kanë arritur të integrohen dhe kanë kaluar klasën. Prindërit e tyre na kanë vlerësuar maksimalisht dhe këtë vlerësim, e kanë shprehur edhe në komisionin e ZVA. Para disa vitesh shkolla ka marrë certifikatë për punën e gjithanshme që ka bërë me nxënësit me AK. Kemi këshilluar dhe nxitur nxënësit e klasës së nxënësve me AK që t’i duan, ndihmojnë dhe shoqërohen me ta. Mësuesit e kanë dashur O, përkrahur, kanë qëndruar me të, kanë dëgjuar muzikë së bashku, e kanë nxitur që të artikulojë, kanë kërcyer me të. Mësuesja kujdestare e ka dashur shumë, e mbante shumë afër që ta bënte të reagonte sadopak, ka biseduar shpesh me mësuesen ndihmëse dhe të tjerët për t’a nxitur nxënësin që të reagonte sadopak. E kemi përfshirë në aktivitete të shkollës me qëllim që të socializohet por ai ka qëndruar indiferent. Shumë mësues të shkollës kanë gjetur kohën dhe individualisht janë përpjekur ta nxisin që të reagonte. Nuk është diskriminim që nxënësi vlerësohet sipas rezultateve të të nxënët në zbatim të udhëzimit të cituar më herët në këtë shkresë. Nxënës me AK kanë mbetur edhe në provimet e Maturës Shtetërore. A ka vend për akuzë për diskriminim ? Aspak. Nxënësi nuk artikulon, nuk kopjon, nuk kupton, nuk shkruan, nuk shfaq emocione, nuk shfaq interes për bashkëveprim dhe socializim. Shkolla ka zbatuar të gjitha detyrat që i përkasin asaj në zbatim të Urdhërit të MAS nr.31, datë 28.01.2020 për miratimin e “Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, neni 83 “Komisioni i institucionit arsimor të zakonshëm”. Në dëshirën dhe detyrimin për të ndihmuar nxënësin, shkolla përmes psikologut të shkollës që me 21 dhjetor 2022, i ka kërkuar me email Komisionit psikosocial në ZVA që të vlerësonte nxënësin dhe të na jepte rekomandime se çfarë duhet të bëjmë më shumë, por asnjëherë nuk u përgjigj. Kjo nuk na ka penguar asnjëherë që ne të ushtrojmë detyrën tonë. Bashkëlidhur gjeni e-mailin dërguar komisionit psikosocial të ZVA. Sipas ngarkesës mësimore, O, i takonin 10 orë me mësues ndihmës dhe, unë, i kam kërkuar mësueses ndihmëse që të rrinte 20 orë në javë me të në mësim. Është rasti i vetëm në Tiranë, dhe në kundërshtim me udhëzimin e MAS-it për mësuesin ndihmës, që një mësuese ndihmëse të punojë vetëm me një nxënës me AK. A mund të quhet diskriminim ky fakt? Ka mbështetje më të mirë? Kemi orë të tëra takimesh me mësues, me anëtarët e drejtorisë, me shërbimin psikosocial me rend dite si ta nxisim O, që të reagojë, të arrijë të bëjë diçka, por ai nuk ka reaguar dhe komisioni i shkollës ka arritur në vlerësimin se ai nuk ka progres fare në lëndët mësimore. Pavarësisht përpjekjeve të

shkollës për përparimin e O, prindi i tij nuk ka qenë bashkëpunues. Atij i interesonte vetëm fakti që djalin ta ketë në shkollë, për të qenë i lirë në angazhimet e tij në punë private. Në një nga takimet, ai më quajti antihumane sepse i paskam hequr mundësinë e marrjes së 100 mijë lekëshit (i vjetër) mujor që merrte nga shteti. Në mbledhjen e datës 05.10.2022, në drejtori, me mësuesen ndihmëse dhe me mësuesen kujdestare për ecurinë e O, mësuesja ndihmëse ka deklaruar se “është rast i rëndë për t'u menaxhuar, nuk merr asnjë komandë, nuk kupton fare. Është i vështirë”. Pas këtij deklarimi të mësueses ndihmëse, unë dhe psikologu i shkollës kemi hartuar një instrument nxitës dhe monitorimi të ecurisë së tij për të parë vijueshmërinë. Në mbledhjen me stafin me datën 01.12.2022 për ecurinë e O, mësuesit kanë konstatuar se nxënësi nuk reagon dhe nuk përfiton asgjë. Nisur nga ky fakt, unë i kam kërkuar psikologut që të kërkojë vlerësim nga komisioni psikosocial i ZAV, i cili nuk u përgjigj asnjëherë me shkrim. Bashkëlidhur keni korespondencën dërguar këtij komisioni, është cituar edhe më lart. Takimet drejtori, shërbim psikosocial për nxënësit me AK dhe sidomos O, janë të shumta gjatë gjithë vitit shkollor. Përfundimisht, shkolla ka zbatuar ligjin në raport me nxënësin dhe nuk ekziston asnjë tregues diskriminimi ndaj tij. Zbatimi i ligjit në shkollës nuk përfaqëson asnjë shkëlqje diskriminimi i pretenduar nga prindi.

6. Përgjigja e dërguar sëbashku me dokumentacionin përkatës, iu komunikua ankuesit z. M. H, me shkresën nr. 1165 prot., datë 25.10.2023 të Komisionerit. Pala ankuese me shkresën nr.1202 prot., datë 30.10.2023 ka dërguar parashtrimet e tija në lidhje me shkresën nr. 54, datë 26.09.2023 të Gjornazit “Aleks Buda”, ku i qëndron pretendimit për diskriminim nga Drejtoria e Gjornazit “Aleks Buda” duke kërkuar vënien e drejtësisë dhe marrjen e masave nga institucionet përkatëse për zgjidhjen e këtyre problemeve që hasin fëmijët me aftësi të kufizuar.
7. Bazuar në nenin 33/8, të LMD, ku parashikohet: “Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar”, dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri me shkresën nr. 1008/3 prot., datë 30.10.2023, njoftoi palët: ankuesin z. M. H, Gjornazin “Aleks Buda”, Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë, Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës, Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 14.11.2023.

Seanca dëgjimore e datës 14.11.2023 u zhvillua me pjesëmarrjen e ankuesit z. M. H, dhe palëve Gjornazi “Aleks Buda”, përfaqësuar nga Drejtoresha znj.Valdete Bujupi, Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë, përfaqësuar nga z.S. K, Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, përfaqësuar nga znj. R. P, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, përfaqësuar nga znj.M. R, ndërsa Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës nuk mori pjesë. Në seancë dëgjimore mori pjesë edhe znj. Z. Ç, në cilësinë e mësueses ndihmëse të nxënësit O. H.

Gjatë seancës dëgjimore ankuesi i qëndroi të njëjtave parashtrime duke pretenduar se, nga Drejtoria e Gjimnazit “Aleks Buda”, djali i tij është diskriminuar në mënyrë të vazhdueshme e të qëllimshme, nuk ka patur trajtimin e duhur nga ky gjimnaz, shkelje të cilat janë kostatuar dhe nga ZVA Tiranë. Prindi ka pretenduar që iu ka bërë të qartë Drejtorisë së shkollës dhe mesueses kujdestare që fëmija bazuar në aktet ligjore nuk mund të ngelet në klasë pasi, sipas prindit, i është thënë që në fillim nga ana e tyre që femija do ngelet në klasë nëse nuk përgjigjet në mësim, si dhe do të përjashtohet për mungesa. Gjithashtu prindi pretendoi se nuk është thirrur asnjëherë nga shkolla për të diskutuar për djalin e tij si dhe ishte shumë e vështirë të takosh drejtoreshën e shkollës. Pretendimet e ankuesit u mbështetën dhe nga mësuesja ndihmëse e nxënësit O. H, znj. Z. Ç, prezente në seanën dëgjimore, e cila ka përforcuar faktin që është mënjanuar dhe nuk është përfshirë në hartimin e programit PEI, në cilësinë e mësueses ndihmëse të nxënësit O. H. Sipas znj.Ç, shkak për këtë situatë është bërë keqmenaxhimi i situatës që nga fillimi nga drejtoria e shkollës. Znj. Ç pohon në seancë se ndryshimi i ambjentit fizik për këtë vit ka bërë që O, të jetë krejt ndryshe. Sipas Znj. Ç për nxënësin S.D, edhe pse kishte 10 orë mbështetje me mësues ndihmës nga ZVA, është hartuar plani PEI sipas rregullores për të gjitha lëndët mësimore, ndërsa për O, me justifikimin se “O, sdi të bëjë asgjë” u bë plani PEI vetëm për disa lëndë mësimore për 3-mujorin e parë. Kjo ka ndikuar në vijimësi në rezultatet e arritura nga ana e nxënësit, por dhe të gjendjes së tij emocionale. Duke bërë krahasimin me shkollën aktuale që është rregjistruar vërehet ndryshimi i tij, pasi ka gjetur një ambjent më të ngrohtë dhe më bashkëpunues.

Gjatë seancës dëgjimore, znj B, theksoi faktin që rasti i O, ishte një rast i vështirë dhe se ishte hera e parë që kishin një fëmijë të një niveli të tillë ku nxënësi nuk artikulon, nuk shkruan, nuk komunikon, nuk ka kontakt me sy dhe nuk tregon me gisht. Sipas saj për nxënësit e tjerë me AK në këtë shkollë nuk janë ngritur problematika nga prindërit.

Znj. B, pranoi në seancë që nxënësi O. H, nuk është ndjekur me plan PEI në të gjitha lëndët në 3-mujorin e parë, duke pranuar që ky nxënës duhet të ishte ndjekur me plan PEI në të gjitha lëndët sipas vlerësimeve të komisionit pranë ZVA. Për këtë znj. B ngarkon me faj komisionin e shkollës dhe mësuesen ndihmëse.

Nga znj. B, u konfirmua se gjatë 3-mujorit të parë nxënësi Olsion Hoxha ishte ndjekur me plan PEI në lëndët : Matematikë, Biologji, Histori, Qytetari dhe Edukim Fizik si dhe u konfirmua nga palët në proces se nxënësi O. H, kishte ngelur në lëndët: Gjuhë, Letërsi, Kimi, Frëngjisht,Tik dhe Matematikë.

Gjatë seancës dëgjimore përfaqësuesi i ZVAP Tiranë sa i takon pretendimit të shkollës për rregjistrimin mbi moshë, theksoi se ishin mbështetur në një praktikë të ngjashme të vitit 2020. Referuar kësaj praktike për një tjetër rast të ngjashëm, Ministria e Arsimit i është drejtuar ZVAP Tiranë me një shkresë duke vlerësuar se rasti duhet të ishte trajtuar në kushte përjashtimore për të mos i sjellë vështirësi të tjera gjendjes shëndetësore dhe psikologjike të fëmijës. Kjo bazuar në

përcaktimet e nenit 6/5 të ligjit nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” ku theksohet se: “Çdo nxënësi i sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim”. Gjithashtu referuar po kësaj shkrese, citohet se, ligji e lejon ndjekjen e arsimit të mesëm të lartë deri në moshën 21 vjeç dhe rasti konkret i nxënësit X kishte moshë brenda këtij detyrimi. Bazuar në këtë praktikë ZVAP Tiranë, duke vlerësuar interesin më të lartë të fëmijës i është drejtuar shkolles “Aleks Buda” për rregjistrimin e nxënësit.

Më tej përfaqësuesi i ZVAP Tiranë thekson faktin që Komisioni pranë ZVAP Tiranë ka bërë vlerësimin përkatës dhe ka vendosur orët mësimore për tre nxënës të shkollës “Aleks Buda” si më poshtë:

- N.K -- 2 orë në javë
- S.D -- 10 ore në javë
- O. H –18 orë në javë

Sipa ZVAP Tiranë mësuesja ndihmëse ka qenë me ngarkesë të plotë duke kundërshtuar znj. Bujupi se orët i ishin dhënë nga drejtorja e shkollës.

Me tej përfaqësuesi i ZVAP Tiranë parashtroi pranë Komisionerit problematikën sa i takon mbetjes në klasë të nxënësit O. H, për të cilën ishin vënë në dijeni nga ankesa e prindit të fëmijës drejtuar këtij institucioni.

Gjatë seancës dëgjimore Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP), përfaqësuar nga znj. R. P, dhe Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë (ZVAP Tiranë), përfaqësuar nga z. S. K, u shprehën se janë njohur me rastin nëpërmjet ankesës së z. M. H, dhe i qëndrojnë fakteve të konstatuara me shkresën nr.2871/1 prot., datë 04.09.2023.

Gjithashtu, në lidhje me konstatimet e gjetura, nga ana e ZVAP Tiranë, me shkresën nr.2871/2 prot., datë 04.09.2023, i është drejtuar DPAP dhe DRAP Durrës duke kërkuar marrjen e masës disiplinore kundër znj. V. B, drejtore e institucionit arsimor, Gjimnazi “Aleks Buda”.

Me shkresën nr. 2124/4 prot., datë 31.10.2023, DRAP Durrës, iu ka komunikuar DPAP, ZVAP Tiranë dhe Institucionit Arsimor Gjimnazi “Aleks Buda”, Vendimin nr. 23/2023 datë 31.10.2023, në të cilin është vendosur: “Të jepet masë disiplinore “VËREJTJE” për drejtoren e Gjimnazit “Aleks Buda”, Tiranë, znj. V. B.”

Sa i takon qëndrimin në seancë të DPAP, përfaqësuesja e këtij institucioni u shpreh se, bazuar në vlerësimin e Komisionit të shkollës hartohen planet PEI për 3 periudhat, me objektivat minimale dhe maksimale, me qëllim zhvillimin e potencialit intelektual të nxënësit AK, që është qëllimi i vetëm, si dhe në fund të çdo periudhe Komisioni vlerëson nëse janë përmbushur objektivat minimale. Nëse nuk janë përmbushur objektivat minimale, Komisioni i shkollës riharton objektivat.

Sipas perfaqësueses së DPAP, drejtoria e shkollës menaxhon shkollën, mbikqyr rolin e të gjithë punonjësve arsimorë dhe jo-arsimorë brenda institucionit arsimor (IA). Gjithashtu, sipas DPAP, drejtoria e shkollës duhet të monitorojë Komisionin pranë IA për detyrat dhe funksionin që ai ka. Sa i takon ngeljes në klasë të nxënësve me AK, DPAP parashtrori se sipas Urdhërit të MAS nr.31, datë 28.01.2020, nxënësit AK nuk ngelen në sistemin arsimor parauniversitar.

Ministria e Arsimit dhe Sportit, gjatë seancës dëgjimore mbajti qëndrimin se, nga ana e Drejtorisë së Gjimnazit “Aleks Buda”, janë interpretuar gabim dispozitat dhe aktet ligjore në fuqi dhe se qëndrimi i Drejtoreshës znj.V. B, në lidhje me rastin objekt shqyrtimi është i gabuar. Ministria gjatë seancës ishte në një linjë me DPAP dhe ZVAP Tiranë sa i takon ngeljes së nxënësve me AK, ndërsa sa i takon rregjistrimit të nxënësit O. H, sipas Ministrisë rregjistrimi si proces ndodh në klasë të parë dhe të dhjetë. Problematika e rregjistrimit pranë Ministrisë do duhej të shtrohej në klasë të dhjetë.

Gjatë seancës dëgjimore pala ndaj të cilës është bërë ankesa konkretisht Gjimnazit “Aleks Buda”, përfaqësuar nga znj. V. B, deklaroi se i qëndron parashtrësës me shkrim që është depozituar me shkresën nr.54 prot., datë 26.09.2023, që në asnjë moment nuk e ka diskriminuar nxënësin, por përkundrazi e ka ndihmuar me tepër se nxënësit e tjerë dhe se ka zbatuar vetëm ligjin, aktet e dala në zbatim të tij në lidhje me fëmijët më AK, si dhe Udhëzimin nr. 17 datë 05.07.2022 “*Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar*” të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Për arsye të shqyrtimit dhe vlerësimit të mëtejshëm të çështjes nga ana e Komisionerit me shkresën nr. 265 prot., datë 07.02.2024, drejtuar Gjimnazit "Aleks Buda", është kërkuar informacion shtesë, si më poshtë vijon:

Në zbatim të detyrimeve ligjore që ka Gjimnazi "Aleks Buda" sipas pikës 2 të nenit 83 të Rregullores “*Për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë*”, miratuar nga MAS me Urdhërin Nr. 31, datë 28.01.2020, të vendosë në dispozicion:

1. Rekomandimet dhe udhëzimet që Komisioni i IA i ka dhënë mësuesve për hartimin e PEI-ve para se ti miratojë ato dhe ndihmesa që i ka dhënë mësuesve gjatë zbatimit të PEI-ve.
2. Kostatimet e Komisionit të IA për ecurinë e nxënësit me aftësi të kufizuar O. H, gjatë vitit mësimor.
3. Raportet e ecurisë së nxënësit me AK që i ka përcjellë ZVAP Tiranë, sipas formatit të vendosur nga Komisioni i ZVAP Tiranë, për nxënësin O. H.
4. Kopje të vendimeve të Komisionit të ZVAP Tiranë për nxënësit me aftësi të kufizuar N.K dhe S.D (të përmendur në shkresën nr. 6167/1 prot., datë 07.12.2022 të ZVA Tiranë, me lëndë "*Dërgimi i orëve për nxënësit me aftësi të kufizuara*")

Me shkresën nr. 265/1 prot., datë 07.02.2024 të Komisionerit u kërkuar informacion dhe nga ana e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë, si më poshtë:

Në zbatim të detyrimeve ligjore që ZVAP Tiranë ka sipas nenit 80 të Rregullores “Për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, miratuar nga MAS me Urdhërin Nr. 31, datë 28.01.2020, të na vini në dispozicion:

1. Vendimin e Komisionit multidisiplinar për nxënësin O. H, në të cilin janë përcaktuar nevojat arsimore të këtij nxënësi, rekomandimet për planin mësimor dhe programet lëndore, mjetet ndihmëse që i nevojiten nxënësit për të realizuar procesin mësimor-edukativ.
2. Në këtë rregullore është parashikuar gjithashtu që komisioni mbledhet tre herë në vit, për të parë ecurinë e nxënësve me AK, në këto kushte cili ka qenë qëndrimi i Komisionit të ZVAP Tiranë, në lidhje me ecurinë e këtij nxënësi.
3. Komisioni i ZVAP Tiranë, përveç dokumentacionit të gjendjes fillestare të nxënësit me AK, përditëson ecurinë e tij, në bashkëpunim me Komisionin e IA. Në këto kushte, cilat kanë qenë veprimet e ndërmarra nga ZVAP Tiranë, konstatimet mbi ecurinë e këtij nxënësi, duke vendosur në dispozicion dosja e plotë e nxënësit O. H.
4. Në zbatim të detyrimeve ligjore që ZVAP Tiranë ka sipas nenit 81 të Rregullores, në lidhje me nxënësin O. H, a është informuar IA për shërbimet rehabilituese që ofrohen nga institucionet shtetërore shëndetësore dhe a është pajisur nxënësi me mjete ndihmëse për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe zhvillimin personal e ndërpersonal të tij?
5. A ka bashkëpunuar ZVAP Tiranë nëpërmjet NjShPS-së, me mësuesit e shkollës për hartimin dhe vënien në jetë të planit edukativ individual për këtë nxënësi?
6. I njëjti informacion që është kërkuar më sipër, për nxënësin O. H, t'i vihet në dispozicion edhe për nxënësit N.K dhe S.D (të përmendur në shkresën nr. 6167/1 prot., datë 07.12.2022 të ZVA Tiranë, me lëndë "Dërgimi i orëve për nxënësit me aftësi të kufizuara".)

Me shkresën nr.337 prot., datë 12.02.2024, Gjymnazi "Aleks Buda", ktheu përgjigje ku sqaron se:

1. Në lidhje me rekomandimet dhe udhëzimet që Komisioni i Institucionit Arsimor i ka dhënë mësuesve për hartimin e PEI-ve para se t'i miratojë ato, sqarojmë se:

Komisioni i ZVA nuk ka sjellë asnjë vlerësim për këta nxënës. Ai ka sjellë një shkresë ku ka dërguar vetëm numrin e orëve për secilin nxënësi me AK. Edhe pse ky komision nuk ka zbatuar detyrën e tij, Komisioni i IA i ka udhëzuar mësuesit se si të hartohet plani PEI nëpërmjet mbledhjeve të drejtoreshës për mënyrën e hartimit të PEI, ku mësuesit e lëndëve të vendosin rezultatet minimale të nxënësit të përshtatura me atë që nxënësit me AK di të bëjë. Dhe jo me shumë se 2 rezultate të nxënësve. Nëse mësuesi vendos me shumë se 2 rezultatet e të nxënësve, nxënësi mjafton të realizojë minimalisht 1 maksimalisht 2. Udhezimet janë dhënë në:

- *Mbledhjen e drejtorisë me mësuesit;*
- *Në mbledhjen e komisioneve;*
- *Me shkresë të veçantë.*

Pra, mësuesit edhe pse nuk kanë marrë asnjë udhëzim nga Komisioni i ZVA, kanë vijuar njësoj punën për të gjithë nxënësit me AK.

2. Në lidhje me ndihmesën që i ka dhënë mësuesve gjatë zbatimit të PEI-ve.

Kjo kosiston në:

- Mënyrën e bashkëpunimit të mësueses së lëndës me mësuesen ndihmëse.*
- Bashkëpunimi me prindin i cili është rekomanduar që të jetë i përditshëm dhe është realizuar.*
- Takime me mësuesit lëndorë dhe ndihmës.*

3. Kontatimet e Komisionit të IA për ecurinë e nxënësit me AK O. H, gjatë vitit mësimor.

Komisioni i IA ka bashkëlidhur konstatimet e ecurisë së nxënësve.

Për periudhën e 1, vlerësimi i ecurisë së nxënësit nga mësuesja ndihmëse nuk është i saktë dhe i bazuar në produkte.

Për periudhën e 2, vlerësimi i nxënësit O. H, rezulton se nuk ka realizuar asnjë rezultat të nxëni.

Për periudhën e 3, mësuesja ndihmëse nuk është paraqitur në komision për vlerësimin e nxënësit O. H. Ajo ka dorëzuar një vlerësim të parregullt duke ndryshuar datën dhe periudhën e vlerësimit. Komisioni e ka quajtur të falsifikuar. Këtë vlerësim e keni bashkëlidhur. Në këto kushte, komisioni i IA ka administruar testet dhe detyrat e nxënësit dhe ka bërë vlerësimin duke mbajtur procesverbal ku citohet se nxënësi O. H ka regres.

4. Raportet e ecurisë së nxënësit me AK që i ka përcjellë ZVA-së, sipas formatit të vendosur nga komisioni i ZVA-së, për nxënësin O. H. (Ky informacion të jetë i shoqëruar me shkresat përcjellëse respektive që janë dërguar raportet pranë ZVA-së)

Raportet e ecurisë së bashku me diagnozën janë dërguar fizikisht (sepse kështu i kërkoi komisioni i ZVA) në 22 qershor 2023, moment kur ky komision vlerëson nxënësit nëse kanë nevojë për mësuese ndihmëse. Komisioni i ZVA ka kërkuar kryetaren e komisionit të IA (psikologen) që të çojë gjithë dosjen e plotë për nxënësit me AK, O, S, kurse N. K nuk ka pranuar mësuese ndihmëse. Bashkëlidhur keni deklaratën e prindërit për këtë gjë. Dosja e O, u administruar nga ZVA dhe ndodhet atje dhe është lehtësisht e verifikueshme.

Me shkresën nr.6167/1 prot., datë 07.12.2022, me lëndë: Dërgimin e orëve për nxënësit me aftësi të kufizuara, janë përcaktuar orët dhe për nxënësit N.K dhe S.D, në këto kushte të na vihen në dispozicion vendimet e komisionit të ZVA-së për këta nxënës si dhe PEI përkatës të secilit për të treja periudhat e vlerësimit nga komisioni i IA-së.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë shkresat e ZVA për përcaktimin e mësuesve ndihmës si dhe orët e mësimi:

- Z. Ç, ka ardhur me shkresën e ZVA, datë 27.09.2022 dhe duke qenë e përcaktuar si punonjëse vetëm në Gjimnazin "Aleks Buda", ajo ka pasur 20 orë vetëm me O.*
- B. D, ka ardhur në shkollë me shkresën e ZVA, datë 03.11.2022 dhe duke qenë se shkresa e cakton në 2 shkolla, atëherë ajo ka 10 orë në Gjimnazin "Aleks Buda", përkatësisht me nxënësin S.D dhe 10 orë në Gjimnazin "Qemal Stafa".*

- Me shkresën nr.6167/1 prot., datë 07.12.2022, "Dërgimin e orëve për nxënësit me aftësi të kufizuara", përcaktohen përsëri orët e nxënësve me mësues ndihmës.

Përcaktimi i mësuesve sipas nxënësve është kompetencë e drejtoreshës së shkollës e cila ka bashkëpunuar me psikologun e shkollës për të gjetur mënyrën më të mirë në funksion të nxënësit dhe kështu u përcaktua si vijon:

- N. K, 2 orë të cilat iu ngarkuan mësueses Z. Ç, ajo nuk i realizoi asnjëherë, edhe pse nxënësja nuk donte mësuese ndihmëse në klasë, kësaj të fundit iu kërkua nga drejtoresha asistimi fizik në hyrje dhe dalje, por nuk iu dha. Në këto kushte, drejtorja dhe unë i kemi kërkuar mësueses kujdestare dhe nxënësve që ta asistojnë nxënësen N.K, në lëvizje dhe ky shërbim iu dha me shumë dashamirësi nga ata. N. K, sot fjalë bashkëpunimit të drejtorit, shërbimit psikosocial, mësuesit dhe nxënësit mëson vet dhe ka arritje të kënaqshme. Ajo e do shkollën dhe shoqërinë e klasës.

- S. D ka 10 orë me mësuese B. D, e cila me punën e saj me përkushtim dhe në bashkëpunim të përditshëm me prindin, shërbimin psikosocial, mësuesit lëndor dhe mësuesin kujdestar ka arritje të kënaqshme në mësim dhe merrë pjesë në të gjitha aktivitetet e shkollës. Ai mërzhitet kur kemi pushime sepse nuk mund të rrijë pa ardhur në shkollë.

- O. H, 18 orë me mësuesen ndihmëse Z. Ç. e cila nuk bashkëpunoi asnjëherë dhe nuk pati sukses në punën e saj. Për këtë arsye drejtoresha e ka vlerësuar "Dobët", me shkresë i ka kërkuar ZVA që ajo të mos jetë me mësuese ndihmëse në shkollë, por ajo dëshironte një mësuese tjetër të aftë.

Me shkresën nr. 910/1 prot., datë 15.02.2024 Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë, ka kthyer përgjigje dhe ka informuar se:

- Komisioni Multidisiplinar për Aftësinë e Kufizuar (KMD), pranë ZVAP, Tiranë ka kryer vlerësimin fillestar të nevojave arsimore të nxënësit O.H, nxënës i klasës së X-të, në Gjimnazin "Aleks Buda", Tiranë, më datë 10.10.2022. Nxënësi është vlerësuar në prani të prindit dhe psikologut të shkollës. Në përfundim të procesit të vlerësimit, KMD ka dhënë rekomandimet përkatëse, të cilat janë të pasqyruara në kartelën e vlerësimit, i janë bërë me dije prindit dhe janë përcjellë në formë zyrtare institucionit arsimor përkatës.

- KMD në zbatim të Ligjit nr.66/2012 "Për sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" dhe Urdhërit nr.31, datë 28.01.2020 "Për miratimin e Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë", neni 80, pika 4 "Komisioni mbledhet 3 herë në vit, para fillimit të vitit shkollor, në fund të periudhës së parë dhe në fund të vitit mësimor".

Ju sqarojmë se mbledhja e KMD tre herë në vit, nuk nënkupton vlerësimin e çdo nxënësi tre herë në vit, por KMD mbledhet tre herë në vit për të vlerësuar nevojat e nxënësve sipas kërkesave të prindërve ose institucioneve arsimore.

Vlerësimi i ecurisë së nxënësve me AK, vlerësohet nga komisioni i institucionit të zakonshëm për aftësinë e kufizuar në fund të çdo periudhe, i cili i paraqet KMD-së raportin e ecurisë së nxënësit me AK, sipas formatit të miratuar (Neni 83, pika 2, gërma ç)

Dokumentacionin e gjendjes fillestare të nxënësit dhe përditësimin e ecurisë, për nxënësin O.H e gjeni bashkëlidhur.

- Në zbatim të detyrimeve ligjore që ZVA ka sipas nenit 81 të Rregullores ka pajisur nxënësin me tekste falas dhe nëpërmjet KMD-së është informuar prindi për shërbime të tjera jashtë IA-së në përputhje me nevojat e vlerësuara, kjo e pasqyruar dhe nënshkruar nga prindi në kartelën e vlerësimit.

- Zyra Vendore Arsimore, Tiranë, nëpërmjet NJSHPS, shërbimit psiko-social në shkollë dhe komisionit të institutit arsimor të zakonshëm për aftësinë e kufizuar, ka bashkëpunuar me stafin mësimor për hartimin dhe zbatimin e planit edukativ individual për nxënësin O.H.

Dokumentacionin e gjendjes fillestare të nxënësit dhe përditësimin e ecurisë, për nxënësin N. K dhe S. D, e gjeni bashkëlidhur.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë.

Në lidhje me këtë ankesë Komisioneri u ndal në trajtimin e dy momenteve së pari atë të ngeljes në klasë të nxënësit O. H, dhe së dyti në momentin që nga ana e Gjimnazit ky nxënës nuk u regjistrua si përsëritës në klasën e X, që të vijonte shkollimin në këtë Gjimnaz.

Bazuar në informacionin dhe provat e administruara gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës, rezultoi se, ankuesi z. M. H, është babai i një djali me aftësi të kufizuar të quajtur O. H, i datëlindjes 05.07.2003 dhe përfaqëson në këtë proces, djalin e tij, i cili është banues në Laprakë, Bashkia Tiranë.

Mbështetur në informacionin e administruar gjatë shqyrtimit, referuar vërtetimit për përfitimin për shkak të aftësisë së kufizuar, të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror, O. H, është vlerësuar me dy diagnoza, e para çrregullim i spektit autik dhe e dyta aftësia e kufizuar intelektuale (prapambetje mendore).

Ky fakt është evidentuar dhe në Planit të Edukimit Individual (PEI) për vitin mësimor 2022-2023 të vënë në dispozicion nga ana e Gjimnazit “Aleks Buda”, ku nxënësi O. H, është vlerësuar si person me aftësi të kufizuar, diagnostifikuar me sindromën down dhe prapambetje mendore të rëndë.

Djali i ankuesit, nxënësi O. H, ka përfunduar klasën e nëntë të arsimit të mesëm të ulët me kohë të plotë në vitin shkollor 2021-2022, pranë shkollës 9-vjeçare publike “Dhora Leka” Tiranë.

Me shkresën nr.8762 prot., datë 15.09.2022 të ZVAP Tiranë është mundësuar regjistrimi i tij në klasën e X (dhjetë) në vitin shkollor 2022- 2023 në Gjimnazin “Aleks Buda” Tiranë.

Me shkresën nr. 6167/1 prot., datë 07.12.2022 të ZVAP Tiranë, me lëndë: "*Dërgim i orëve për nxënësit me aftësi të kufizuar*", drejtuar Gjimnazit "Aleks Buda ", është rekomanduar që për nxënësin O. H, të caktohet mësuese ndihmëse për 18 orë.

Referuar Vlerësimit Psiko-Edukativ datë 31.5.2023 të Gjimnazit "Aleks Buda" Tiranë, ndër të tjera janë rekomanduar strategji dhe mënyra për të ndihmuar nxënësin dhe për të lehtësuar situatën, por dhe nevojën për të ofruar shërbime.

Ndërkohë referuar Vlerësimit të ecurisë për periudhën e III-të, Komisioni i Gjimnazit, ka dal në konkluzionin se duke iu referuar rezultateve të arritura gjatë periudhës prill-qershor, është kostatuar se nxënësi O. H, ka paraqitur regres.

Në kushtet e mësipërme është rekomanduar:

- 1- Që nxënësi të frekuentojë shkollën është e domosdoshme trajtimi i nxënësit me planin PEI edhe në vitin e ardhshëm dhe vendosja e objektivave minimale duke i përshtatur me ritmet e zhvillimit të tij dhe mundësitë që ai ka.*
- 2- Të analizohet fakti nëse nxënësi me AK mund të përballojë frekuentimin e shkollës prej një harku kohor katër orë në ditë, referuar mundësive të tij.*

Nxënësi O. H, ka përfunduar klasën e X (dhjetë) gjatë vitit shkollor 2022-2023 dhe ka rezultuar ngelës në gjashtë lëndë mësimore. Gjatë gjithë vitit shkollor, referuar informacionit të administruar, është vlerësuar nga komisioni multidisiplinar dhe është trajtuar me mësues ndihmës me 18 (tetëmbëdhjet) orë mësimore në ditë.

Gjatë seancës dëgjimore znj. B, konfirmoi se gjatë 3-mujorit të parë nxënësi O. H, ishte ndjekur me plan PEI në lëndët : Matematikë, Biologji, Histori, Qytetari dhe Edukim Fizik si dhe u konfirmua nga palët në proces se nxënësi Olsion Hoxha për vitin shkollor 2022-2023 kishte ngelur në lëndët: Gjuhë, Letërsi, Kimi, Frëngjisht, Tik dhe Matematikë.

Referuar planit PEI për periudhën e I-rë:

Gjatë 3-mujorit të parë nxënësi O. H, është ndjekur me plan PEI në pesë lëndë dhe konkretisht: Matematikë, Biologji, Histori, Qytetari dhe Edukim Fizik.

Referuar planit PEI për periudhën e II-të:

Gjatë 3- mujorit të dytë nxënësi O. H, është ndjekur me plan PEI për të gjitha lëndët mësimore.

Referuar planit PEI për periudhën e III-të:

Gjatë 3-mujorit të tretë të vitit mësimor nxënësi është ndjekur me plan PEI për të gjitha lëndët mësimore.

Në fund të vitit nxënësi O. H, ka rezultuar ngelës në lëndët: Gjuhë, Letërsi, Kimi, Frëngjisht, Tik dhe Matematikë.

Ndërkohë, nga dokumentacioni i depozituar nga Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë, rezultoi se është propozuar nga Komisioni Multidisiplinar për Aftësinë e Kufizuar që ky nxënës të ndiqet me 18 orë me mësuese ndihmëse.

Sa më sipër Komisioneri konstaton se nxënësi O. H, rezultoi ngelës në të gjitha lëndët që nuk ishte ndjekur me plan PEI në periudhën e parë të vitit, përveç lëndës së matematikës në të cilën rezultoi ngelës gjithashtu edhe pse ishte ndjekur me plan PEI.

Gjithashtu Komisioneri konstatoi diferencë në trajtim, sa i takon ndjekjes me plan PEI, ndërmjet nxënësit O. H, dhe nxënësit S.D, edhe pse për nxënësin O. H, ZVAP Tiranë kishte rekomanduar normë të plotë, 18 orë mësimore.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion për nxënësin S.D, rezultoi se, nga ana e Komisionit Multidisiplinar për Aftësinë e Kufizuar, pranë ZVAP Tiranë është propozuar që ky nxënës të ndiqet me 10 orë me mësuese ndihmëse.

Ndërkohë sipas planeve PEI për të tre periudhat, rezultoi që, ky nxënës është mbuluar me plan PEI për të gjitha lëndët mësimore.

Nga shpjegimet që ka dhënë ZVAP Tiranë në lidhje me ndjekjen e ecurisë së nxënësve me aftësi të kufizuar gjatë vitit mësimor, kjo e fundit ka shpjeguar se:

Mbledhja e KMD tre herë në vit, nuk nënkupton vlerësimin e çdo nxënësi tre herë në vit, por KMD mbledhet tre herë në vit për të vlerësuar nevojat e nxënësve sipas kërkesave të prindërve ose institucioneve arsimore.

Vlerësimi i ecurisë së nxënësve me AK, vlerësohet nga komisioni i institucionit të zakonshëm për aftësinë e kufizuar në fund të çdo periudhe, i cili i paraqet KMD-së raportin e ecurisë së nxënësit me AK, sipas formatit të miratuar (Neni 83, pika 2, gërma ç)

Ndërkohë nga ana e Komisionerit, është pyetur dhe Gjumnazi "Aleksi Buda", në lidhje Raportet e Ecurisë së nxënësit me AK që i ka përcjellë ZVAP-së Tiranë, sipas formatit të vendosur nga komisioni i ZVAP-së, për nxënësin O. H. Në lidhje me këtë moment, nga ana e Gjumnazit është shpjeguar se:

Raportet e Ecurisë së bashku me diagnozën janë dërguar fizikisht (sepse kështu i kërkoi komisioni i ZVA) në 22 qershor 2023, moment kur ky komision vlerëson nxënësit nëse kanë nevojë për mësuese ndihmëse. Komisioni i ZVA ka kërkuar kryetaren e komisionit të IA (psikologen) që të çojë gjithë dosjen e plotë për nxënësit me AK, O, S.D kurse N. K nuk ka pranuar mësuese ndihmëse.

Pavarësisht pretendimit të mësipërm, Gjimnazi “Aleks Buda”, nuk arriti të provojë që këto raporte ishin përcjellë në mënyrë periodike pranë Zyrës Vendore Arsimore Tiranë, gjithashtu nuk rezultoi që problematika e hasur në lidhje me ecurinë e këtij nxënësi t’i jetë adresuar ZVAP-së Tiranë.

Nga ana e Gjimnazit, pretendohet se regresi që ka patur nxënësi O. H, më së shumti ka të bëjë me faktin që mësuesja ndihmëse nuk bashkëpunoi asnjëherë dhe nuk pati sukses në punën e saj. Për këtë arsye drejtoresha e shkollës e ka vlerësuar me "Dobët" dhe me shkresë i ka kërkuar ZVAP-së Tiranë që ajo të mos jetë më mësuese ndihmëse në këtë shkollë, por ajo dëshiron një mësuese tjetër të aftë. Gjatë shqyrtimit të ankesë, ky pretendim nuk u vërtetua me ndonjë provë shkresore nga ana e Gjimnazit.

Situata e mësipërme e krijuar midis mësueses ndihmëse dhe stafit të Gjimnazit është sqaruar nga mësuesja ndihmëse gjatë seancës dëgjimore, duke deklaruar se, që në fillim është bërë diferencimi i nxënësit O. H, si rast i veçantë, i rëndë dhe i pashpresë nga ana e drejtoreshës së institucionit në lidhje me këtë nxënësi, duke e mënjeluar dhe duke mos i dhënë mbështetjen e nevojshme si nxënësit ashtu edhe mësueses ndihmëse.

Detyrat e mësuesit ndihmës në arsimin parauniversitar, përcaktohen dhe rregullohen nga udhëzimi nr.26, datë 25.11.2019 “Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”, por në çdo rast ai trajtohet si pjesa tjetër e stafit të shkollës i cili menaxhohet/administrohet dhe drejtohet nga drejtuesi i institucionit arsimor.

Ndërkohë referuar shkresës nr. 2871/1 prot., datë 04.09.2023, të ZVAP Tiranë, me lëndë “Kthim përgjigje Z. M. H, kontakt 068.....”, rezulton se, prindi është vënë në dijeni për faktin që djali rezulton ngelës në gjashtë lëndë mësimore në datën 21.06.2023, fakt i cili u theksua nga z. M. H, gjatë seancës dëgjimore, në kundërshtim me përcaktimet e parashikuara në Urdhërin nr.31, datë 28.01.2020 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e Rregullores për Funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, konkretisht neni 80 i saj ku citohet se: “Komisioni njofton personin që ushtron përgjegjësinë prindërore për gjendjen dhe ecurinë e fëmijës...”

Në kushtet e mësipërme nga ana e z. M, H, është bërë ankesë pranë ZVAP Tiranë. Bazuar në ankesën e z.H, ZVAP ka kërkuar informacion dhe të gjithë dokumentacionin shkollor/ligjor të detyrueshëm që korrespondon me ndjekjen e shkollës dhe vlerësimin e nxënësit me AK, nga

Gjimnazi "Aleks Buda", Tiranë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit sipas shkresës nr.2871/1 prot., datë 04.09.2023 të ZVAP Tiranë, ka rezultuar se:

Referuar Zyrës Vendore Arsimore Tiranë, Plani PEI i nxënësit O.H, nuk është hartuar plotësisht (në disa prej lëndëve mësimore Historia, Tik, Letërsia) me nevojat e vlerësuara dhe zhvillimin e tij. Vetëm për periudhën e parë ky plan është hartuar me objektiva specifike në përputhje me nevojat zhvillimore të këtij nxënësi, ndërsa për dy periudhat në vazhdim, mësuesja ndihmëse e këtij nxënësi nuk ka qenë e përfshirë në hartimin e PEI përkatës. Në disa lëndë të caktuara nuk është hartuar në përputhje me vlerësimin dhe nevojat e tij.

- 1. Në hartimin e testeve lëndore/detyrave përmbledhëse në përfundim të periudhave nuk është e përfshirë mësuesja ndihmëse e këtij nxënësi dhe disa prej testeve lëndore nuk janë hartuar në përputhje me nevojat dhe zhvillimin e tij.*
- 2. Komisioni i shkollës për nxënësit me AK, i datës 29.09.2022 nuk është ngritur sipas përcaktimeve të Urdhërit Nr.31, datë 28.01.2020 "Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë". Ringritja e këtij komisioni në muajin shkurt është sipas përcaktimeve të urdhrit të mësipërm, por nuk ka të përfshirë mësuesen ndihmëse të këtij nxënësi, çka sjellë pavlefshmërinë e vendimeve të këtij komisioni. Dhe në procesverbalin e Komisionit të IA për nxënësit me AK, i datës 15.06.2023 për ecurinë e nxënësit O.H, nuk është e përfshirë mësuesja ndihmëse e tij.*
- 3. Nga ana e këtij institucioni arsimor nuk është bërë sa duhet për mirëqenien dhe integrimin e këtij nxënësi në mjedisin shkollor, pasi dhe vetë qëllimi i arsimit parauniversitar është zbatimi i parimit të gjithëpërfshirjes së nxënësve në IA të zakonshme si dhe është çenuar interesi primar i këtij nxënësi, pasi në vijueshmëri nuk është punuar në përputhje me nevojat dhe zhvillimin mendor të këtij fëmije.*

Stafi drejtues dhe stafi mësimor (mësuesi ndihmës, mësuesi kujdestar, mësuesit lëndorë, psikologu) nuk kanë realizuar detyrat funksionale në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi dhe në përfundim të vitit mësimor 2022-2023, 5 prej këtyre mësuesve lëndorë kanë ngelur në klasë këtë nxënësi, veprime të cilat janë në shkelje të hapur të Urdhërit Nr.31, datë 28.01.2020 "Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë", Kreut XIV, Neni 84 "Ndjekja e shkollës, vlerësimi i nxënësve me AK, dokumente të përfundimit të shkollimit ", në pikën 5, është përcaktuar se:

"Nxënësit me AK e përsërisin klasën në raste të veçanta, kur komisioni i IA-së dhe personi që ushtron përgjegjësinë prindërore çmon dobinë e përsëritjes. "

Për gjithë sa më sipër, referuar faktit që nga ana juaj si prind nuk është paraqitur asnjë kërkesë për përsëritje të klasës së X të fëmijës, ngelja e këtij nxënësi në klasën e X është bërë në kundërshtim të hapur të akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Gjatë shqyrtimit të ankeses, nga ana e Gjimnazit "Aleks Buda", është pretenduar që vlerësimi i këtij nxënësi është bërë bazuar në Udhëzimin nr. 17, datë 05.07.2022 "Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar", konkretisht neni 10, pika 1, parashikohet se: *Vlerësimi i nxënësve me aftësi të kufizuar, për nxënësit që punojnë me Plan Edukativ Individual, të bëhet bazuar në rezultatet e të nxënësve të përcaktuar në PEI sipas rubrikave të këtij plani, i ndarë me periudha.*

Sa më sipër Komisioneri vlerëson se, Urdhëri 31, datë 28.01.2020 "Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë" është në fuqi dhe ka përcaktuar qartë në Kreun XIV, neni 84 "Ndjekja e shkollës, vlerësimi i nxënësve me AK, dokumente të përfundimit të shkollimit", në pikën 5 se: "Nxënësit me Ak e përsërisin klasën në raste të veçanta, kur komisioni i IA-së dhe personi që ushtron përgjegjësinë prindërore çmojnë dobinë e përsëritjes."

Sa i takon udhëzimit nr. 17, datë 05.07.2022 "Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar", konkretisht pikës 1, ku parashikohet se: "1. Vlerësimi i nxënësve me aftësi të kufizuar, për nxënësit që punojnë me Plan Edukativ Individual, të bëhet bazuar në rezultatet e të nxënësve të përcaktuar në PEI sipas rubrikave të këtij plani, i ndarë me periudha. 2. Për nxënësit me AK që punojnë me kurrikulën e zakonshme vlerësimi kryhet njësoj si për nxënësit e tjerë", Komisioneri bazuar në faktet dhe provat vlerëson se, sa i takon nxënësit O. H, duhet të ishte ndjekur me plan PEI në të gjitha lëndët, pranuar kjo edhe nga drejtoresha e shkollës. Gjatë 3-mujorit të parë në kundërshtim me vlerësimin e Komisionit Multidisiplinar pranë ZVAP-së Tiranë, ky nxënës nuk ishte mbuluar me plan PEI në lëndët Gjuhë, Letërsi, Kimi, Frëngjisht, Tik në të cilat rezultoi edhe ngelës në fund të vitit.

Sa i takon udhëzimit nr. 17, datë 05.07.2022 "Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar", Komisioneri vlerëson se nuk jemi në kushtet e këtij udhëzimi pasi nxënësi O. H, nuk duhej të punonte me kurrikulën e zakonshme si pasojë edhe vlerësimi i tij do duhej të bëhej sipas objektivave specifike të përcaktuara nga komisioni i shkollës.

Ndërkohë referuar shkresës nr.2871/1 prot., datë 04.09.2023 të ZVAP Tiranë, është konstatuar se, që në fillim plani PEI i hartuar nga Komisioni i IA, konkretisht Gjimnazi "Aleks Buda", nuk është hartuar plotësisht me nevojat e nxënësit, mësuesja ndihmëse e këtij nxënësi nuk është përfshirë në disa prej testeve lëndore të cilat nuk janë bërë në përputhje me nevojat e zhvillimit të tij. Këto fakte janë të evidentuara nga ZVAP Tiranë, në cilësinë e institucionit epror që ka për detyrë të monitorojë dhe kontrollojë mbarvajtjen e institucioneve arsimore në juridiksionin e saj, ku është dalë në përfundimin se: *Komisioni i shkollës për nxënësit me AK i datës 29.09.2022 nuk është ngritur sipas*

përcaktimeve të Urdhërit 31, datë 28.01.2020 "Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipëris". Ndërkohë i njëjti qëndrim dhe analizë është bërë dhe nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit sipas shkresën nr. 5678/5 prot., datë 27.09.2023.

Komisioneri vlerëson se ZVAP Tiranë, pavarësisht se ka reaguar në mënyrë të menjëhershme me marjen e ankesës së z. M. H, nuk solli fakte dhe prova që të provojë ndjekjen e ecurisë së nxënësit O. H, gjatë vitit shkollor si dhe përditësimin e ecurisë së tij, siç parashikohet në Rregulloren "Për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë", miratuar nga MASR me Urdhërin Nr. 31, datë 28.01.2020.

ZVAP Tiranë, nuk rezulton që të ketë dërguar dosjen e plotë me rekomandimet konkrete në lidhje me nxënësin O. H, nuk rezulton të ketë përdorur të gjithë mekanizmat dhe kapacitetet e saj për të ndjekur, identifikuar por dhe kontribuar më shumë në lidhje me nxënësit me AK, që situata të tilla mos të ndodhin në të ardhmen.

ZVA Tiranë, nuk ka rishikuar në mënyrë periodike nëpërmjet strukturave të saj, secilin rast të personave me AK në shkollat respektive, dhe rast pas rasti të propozojë masa konkrete sipas nevojave të këtyre personave.

ZVAP Tiranë, nuk duhet të mjaftojë me faktin që të vihet në lëvizje vetëm në momentin kur i adresohet problematika, por duhet të përdorte të gjithë mekanizmat dhe kapacitetet e saj për të ndjekur, identifikuar por dhe kontribuar më shumë në lidhje me këta nxënës që situata të tilla mos të përsëriten. Komisioneri vlerëson se bashkëpunimi ndërmjet institucioneve sa i takon rastit objekt shqyrtimi nuk ka qenë efektiv.

Për sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë dhe Gjimnazit "Aleks Buda" Tiranë, nxënësi O. H, djali i ankuesit M. H, është vendosur në pozita të pafavorshme duke rezultuar ngelës në klasë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për nxënësit me aftësi të kufizuara.

- **Në lidhje me çështjen e dytë të marrë për shqyrtim nga ana e Komisionerit, është fakti i mosregjistrimit nga ana e Gjimnazit "Aleks Buda" Tiranë, të nxënësit O. H, në klasën e X.**

Në kushtet e sipërcituara, z. M. H, me kërkesën e datës 20.09.2023, i është drejtuar Gjimnazit "Aleks Buda" Tiranë, për ripërsëritjen e klasës së X-të, nga djali i tij O. H.

Me shkresën nr. 41 prot., datë 21.09.2023, Gjimnazi "Aleks Buda" Tiranë i ka kthyer përgjigje, ku parashtron si më poshtë: *Pranimi i djalit tuaj O. H, në klasën e 10-të me kohë të plotë nuk mund të*

bëhet pasi sipas pikës 2 të nenit 23 të Ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kufiri i regjistrimit në klasën e 10-të është deri në moshën 18 vjeç dhe mbarimi i gjimnazit brenda moshës 21 vjeç, citojmë: “ Në klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë me kohë të plotë pranohen nxënës të moshës jo më të madhe se tetëmbëdhjetë vjeç”. Sipas ligjit të sipërcituar dhe akteve nënligjore, O. H, gëzon të drejtën për t’u rregjistruar në gjimnazin me kohë të pjesshme.

Sa më sipër Gjimnazi “Aleks Buda” Tiranë, ka pretenduar se regjistrimi i nxënësit në klasën e X (dhjetë) bazuar në parashikimet e Ligjit nr. 69/2012, është i pamundur dhe si rrjedhojë nuk kanë pranuar ta regjistrojnë. Ndërkohë, nxënësi O. H, ka qenë i regjistruar tashmë në këtë gjimnaz dhe rezulton ngelës, pra nuk jemi para faktit të regjistrimit për herë të parë.

Regjistrimi i nxënësit O. H, është bërë në bazë të shkresës nr.8762 prot., datë 15.09.2022 të ZVAP Tiranë, ku ndër të tjera është cituar se: *“Ky nxënës përbën një rast përjashtimor dhe me prioritet edhe pse ka tejkalar moshën e përcaktuar në LAPU, pasi është me aftësi të kufizuara (Sidroma down). Mbështetur në orientimin e MAS për rastin, si dhe referuar të drejtave të përcaktuara me ligj dhe akte ndërkombëtare, nxënësit me aftësi të kufizuara referuar edhe përcaktimeve që jep Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, të mos i privohet e drejta për arsimim në institucionin arsimor, të cilin ai e ka zgjedhur si më të përshtatshëm. ZVA aprovon regjistrimin në klasën e dhjetë me kohë të plotë të këtij nxënësi për mos i sjellë vështirësi të tjera të gjendjes së tij shëndetësore dhe psikologjike.*

Ministria e Arsimit dhe Sportit me shkresën nr.5678/5 prot., datë 27.09.2023 ka analizuar rastin kur nxënësit me aftësi të kufizuara mund të përsërisin klasën, por në çdo rast me pëlqimin e prindërit kujdestar të fëmijës.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson që në këtë rast, nxënësi ishte në vijimësi dhe nuk mund të diskutohej më regjistrimi i tij në këtë gjimnaz, arsyetim i cili u mbështet dhe nga palët në seancën dëgjimore, si Ministria e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë. Gjithashtu, nxënësi O. H, nuk duhet të ishte as ngelës dhe në çdo rast përsëritja e klasës duhet të bëhet vetëm me miratimin e prindërit.

Gjimnazi “Aleks Buda” Tiranë, ka informuar prindërin në datën 21.06.2023 që nxënësi O. H, ka ngelur në gjashtë lëndë mësimore. Gjithashtu, Gjimnazi nuk ka vënë në dispozicion asnjë provë lidhur me njoftimin e ankuesit, sa i përket mosregjistrimit të djalit të tij për vitin shkollor 2023-2024, që nga muaji qershor deri në muajin tetor 2023. Pra, Gjimnazi ka patur rreth 4 (katër) muaj kohë për të njoftuar ankuesin dhe për ta orientuar atë lidhur me mënyrën se si mund të veprohej për vijimin e klasës së X (dhjetë) për djalin e tij.

Në korrespondencat që kanë vijuar pas ankesës së z. M. H, nga ana e Gjimnazit “Aleks Buda” Tiranë, është pretenduar që në zbatim të Ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në

Republikën e Shqipërisë” kufiri i moshës së regjistrimit në klasën e 10-të është deri në moshën 18 vjeç dhe mbarimi i AML-së brenda moshës 21 vjeç. Ndërkohë që ky pretendim bie ndesh me veprimet e mëparshme të këtij gjimnazi, pasi nxënësi O. H, ndodhej në të njëjtat kushte si një vit më parë, kur është regjistruar dhe ka kryer vitin shkollor 2022-2023 pranë këtij gjimnazi, pra nuk diskutohet më çështja e regjistrimit të tij tashmë të kryer, por fakti i përsëritjes së kësaj klase.

Arsimi parauniversitar në Republikën e Shqipërisë rregullohet sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 69/2012 “*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*”, të ndryshuar (në vijim do t’i referohemi me Ligji nr. 69/2012). Referuar nenit 5, të këtij ligji përcaktohet se: “*1. Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, moshë, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar... ”.*

Neni 6, përcakton parimet e përgjithshme të Ligjit nr. 69/2012, ku parashikohen ndër të tjera se: “*1. Në veprimtarinë e institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar, interesi i nxënësit është parësor. 2. Në sistemin arsimor parauniversitar respektohen, mbrohen dhe promovohen të drejtat e liritë e njeriut në përgjithësi dhe të drejtat e fëmijëve në veçanti. 3. Në sistemin arsimor parauniversitar, nxënësve dhe punonjësve u ofrohet mbrojtje nga çdo formë veprimi ose mosveprimi që mund t’u shkaktojë diskriminim, dhunë, keqtrajtim ose dëm moral. 4. Në institucionet arsimore zbatohet parimi i gjithëpërfshirjes së nxënësve. 5. Çdo nxënësi i sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim. 6. Nxënësve të familjeve në nevojë, nxënësve me aftësi të kufizuara dhe atyre me vështirësi në të nxënë u ofrohet përkujdesje e posaçme, sipas përcaktimeve në këtë ligj... ”.*

Kreu XI i ligjit nr. 69/2012, Arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara, parashikon:

Neni 63 “*Parime të arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara*”:

“*1. Arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara synon zhvillimin e plotë të potencialit intelektual e fizik dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre për t’i përgatitur për integrim të plotë në shoqëri dhe në tregun e punës. 2. Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore të specializuara për ta është përgjithësisht e përkohshme. Përfshirja dhe integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e zakonshme të arsimit bazë është parësore. 3. Nxënësve, që nuk dëgjojnë e nuk flasin, u garantohet e drejta e komunikimit në gjuhën e shenjave, ndërsa atyre që nuk shikojnë, përdorimi i shkrimit Brail.”*

Neni 64, i ligjit nr. 69/2012, përcakton se: “*1. Nxënësve me aftësi të kufizuara u sigurohet arsimimi në shkollat e arsimit të mesëm të lartë, sipas kriterëve të miratuara nga ministri dhe Ministri i Shëndetësisë. 2. Nxënësi me aftësi të kufizuara qëndron në shkollë të specializuara deri në moshën 19 vjeç. 3. Njësia arsimore vendore krijon një komision, të përbërë nga mjekë, psikologë, mësues*

dhe specialistë për fëmijët me aftësi të kufizuara, i cili, pasi shqyrton kërkesën e prindit ose të drejtorit të një institucioni arsimor, jep rekomandimet përkatëse për ndjekjen nga fëmija të një institucioni arsimor të zakonshëm a të specializuar. 4. Prindërit vendosin nëse fëmija e tyre me aftësi të kufizuara do të ndjekë një institucion të specializuar ose të zakonshëm të arsimit bazë. Prindërit mund të largojnë në çdo kohë nga shkolla fëmijën, kur e gjykojnë se ai nuk përfiton nga mësimet ose ka mundësi të tjera më të mira. 5. Ministria, në bashkëpunim me njësinë bazë të qeverisjes vendore dhe në këshillim me prindërit e komisionin, siguron arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në njërin nga dy llojet e institucioneve arsimore, të zakonshme ose të specializuara...”.

Neni 65, "Organizimi i arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara: “ 1. Nxënësit me aftësi të kufizuara mësojnë sipas planit mësimor e programeve lëndore të zakonshme, të përshtatura për ta, ose sipas planit mësimor e programeve lëndore të specializuara për ta. 2. Në institucionet arsimore të zakonshme, programi i personalizuar për nxënësin me aftësi të kufizuara hartohet nga një komision, në përbërje të të cilit janë mësues të fushave të ndryshme të të nxënët të institucionit e psikologë. Hartimi i këtij programi bëhet në bashkëpunim me prindërit e nxënësit. Ndryshimi i programit të personalizuar brenda një institucioni arsimor vendoset nga komisioni brenda institucionit, në bashkëpunim me prindërit e fëmijës. 3. Nxënësve me aftësi të kufizuara u sigurohen mësues ndihmës dhe shërbim rehabilitues, sipas kriterëve të përcaktuara me udhëzim të ministrit. Punonjësit arsimorë të institucioneve, që kanë nxënës me aftësi të kufizuara, certifikohen në programe trajnimit për trajtimin e këtyre nxënësve. 4. Njësia përkatëse bazë e qeverisjes vendore u siguron nxënësve me aftësi të kufizuara mjediset e përshtatshme të mësimdhënies e të të nxënët, sipas standardeve të përcaktuara nga ministria.

Neni 54, i ligjit nr. 69/2012, “Drejtori i Institucionit Arsimor” përcakton se:

1. Drejtori drejton veprimtarinë e institucionit arsimor. 2. Drejtori i institucionit arsimor, publik ose privat, është përgjegjës për: a) zbatimin e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij; b) përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor; c) zbatimin dhe zhvillimin e kurrikulës; ç) menaxhimin e personelit dhe krijimin e kushteve për zhvillimin profesional të punonjësve të institucionit. 3. Drejtori i institucionit arsimor publik kryen edhe këto detyra: a) menaxhon institucionin, përfshirë edhe menaxhimin financiar; b) përdor një fond të veçantë vjetor nga buxheti i njësisë arsimore vendore për shpërblimin për merita profesionale të mësuesve, në përputhje me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, pas këshillimit me partnerët socialë dhe bordin e institucionit; c) punëson mësues me kohë të plotë ose të pjesshme dhe mësues ndihmës, me fonde të siguruara nga institucioni, sipas kriterëve dhe procedurave që përcaktohen me udhëzim të ministrit dhe Ministrit të Financave. Masa e pagesës përcaktohet sipas akteve nënligjore në fuqi. 4. Drejtori i institucionit arsimor lejon të përdoren nga nxënësit vetëm botime ndihmëse dhe materiale të tjera mësimore, të miratuara nga ministri nëpërmjet udhëzimeve të tij.

Rregullorja “Për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, miratuar nga MAS me Urdhërin Nr. 31, datë 28.01.2020, në pikën 3, 4, 7 dhe 10 të nenit 80, ku përcaktohet ngritja e komisionit për fëmijët me aftësi të kufizuara pranë ZVAP-ve, parashikon ndër të tjera se: “...3. Komisioni, me kërkesën e personit që ushtron përgjegjësinë prindërore të fëmijës, ose drejtorit të IA-së, ku fëmija është regjistruar, vlerëson nevojat arsimore të fëmijës dhe ecurinë e tij. 4. Komisioni mblidhet tri herë në vit, para fillimit të vitit shkollor, në fund të periudhës së parë dhe në fund të vitit mësimor... 7. Komisioni: a) njofton personin që ushtron përgjegjësinë prindërore për gjendjen dhe ecurinë e fëmijës; b) i jep me shkrim personit që ka paraqitur kërkesën rekomandimin për ndjekjen nga fëmija të shkollës së zakonshme ose të specializuar, ose kalimin nga shkolla e specializuar në shkollën e zakonshme apo anasjelltas;...10. Komisioni rekomandon ndjekjen e shkollës së specializuar vetëm kur gjykon se ndjekja e një shkolle të zakonshme nuk do të zhvillonte sa duhet fëmijët AK.”

Në nenin 81, pika 1, rregullorja e sipërcituar, parashikon se: “1. ZVA-ja siguron: a) arsimimin e fëmijëve me AK në një IA publik të zakonshëm ose të specializuar; b) arsimimin në shtëpi të nxënësve me AK që nuk mundën të ndjekin shkollë të zakonshme ose të specializuar të arsimit bazë.”

Ndërsa neni 83, i rregullores, përcakton në pikën 2 se: “2. Komisioni i IA-së së zakonshme, bazuar në vlerësimin e komisionit të ZVA-së: a) udhëzon mësuesit për hartimin e PEI-ve dhe i miraton ato; b) ndihmon mësuesit gjatë zbatimit të PEI-ve; c) ndjek ecurinë e fëmijëve AK; ç) paraqet në komisionin e ZVA-së raportin e ecurisë së nxënësit me AK, sipas formatit të vendosur nga komisioni i ZVA-së.”

Neni 88, i rregullores, ku përcaktohen të drejtat dhe detyrat e personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, specifikon në pikën 5 se: “Personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, vendosin nëse fëmija me AK, mbi të cilin ata ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, do të ndjekë një institucion të specializuar ose të zakonshëm të arsimit bazë. Në IA-të e zakonshme hartimi i PEI për nxënësit me AK bëhet në bashkëpunim me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësit. Ndryshimi i PEI brenda një IA-jë vendoset nga komisioni brenda institucionit, në bashkëpunim me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të fëmijës.”

Referuar Kreut X, neni 42, të Rregullores “Për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, miratuar nga MAS me Urdhërin Nr. 31, datë 28.01.2020, është parashikuar se: “1. Drejtori i IA-së është titullari i institucionit, që ka drejtën e firmës dhe vulës institucionit. 2. Drejtori, kur mungon përkohësisht, i delegon me shkrim njërit prej nëndrejtorëve ose një mësuesi të institucionit, kur nuk ka nëndrejtor, duke saktësuar kompetencat e deleguara dhe afatin e delegimit si dhe njofton ZVA-në për këtë delegim. 3. Drejtori ka përgjegjësi zbatimin në IA të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi. 4. Drejtori ka përgjegjësi administrative si dhe penale, në rastet e parashikuara nga ligji, për plotësimin, brenda afateve kohore, të amzës, indeksit të amzës, regjistrimit të veçantë dhe të çdo dokumenti shkollor. 5. Drejtori ka përgjegjësinë për krijimin në institucion të klimës së bashkëpunimit dhe respektit ndërmjet

punonjësve arsimor në institucion. 6. Drejtori krijon mundësi bashkëpunimi të IA-së me institucionet publike dhe private, brenda dhe jashtë vendit, dhe me institucionet analoge. Pas shqyrtimit të këtyre bashkëpunimeve në këshillin e mësuesve, drejtori i IA-së publike merr miratimin për to nga titullari i ZVA-së përkatëse. Në rastet kur organizatat jopublike apo persona të tjerë juridikë kërkojnë të ushtrojnë veprimtari në ambjentet e IA-së, merret miratimi paraprak i ministrisë. 7. Drejtori ka përgjegjësi për zbatimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit të lidhuar nëpërmjet ministrisë dhe institucioneve/palëve të tjera. 8. Drejtori merr masa për të siguruar ndjekjen e shkollës nga nxënësit e arsimit bazë, që i përkasin zonës së shkollës. Drejtori i IA-së publike të arsimit bazë me kohë të plotë bashkëpunon me NjMF-në, këshillin e prindërve të shkollës dhe këshillat e prindërve të klasave, qeverinë e nxënësve, me shërbimin psiko-social dhe me bordin e shkollës për të siguruar ndjekjen e shkollës nga nxënësit.”

Neni 43, Aspekte të manaxhimit të institucionit arsimor, parashikon: “1. Drejtori ka për detyrë të organizojë shpërndarjen e informacionit në dispozicion të qytetarëve, me të dhëna të mjaftueshme për cilësinë e shërbimit arsimor të IA-së. 2. Drejtori, pas këshillimit me këshillin e mësuesve: a) vendos formimin dhe ndarjen e klasave dhe merr miratimin e ZVA-së për këtë ndarje, bazuar në udhëzimin përkatës të ministrisë; b) cakton ngarkesën mësimore të mësuesve dhe merr miratimin e ZVA-së për këtë ndarje; cakton mësuesit kujdestar; ç) harton orarin mësimor javor të institucionit, ose ngarkon nëndrejtor ose mësues për hartimin e këtij orari; d) përgatit çdo muaj listëprezencën e punonjësve të IA-së. 3. Drejtori shpall, në një vend të dukshëm për nxënësit dhe personat që ushtrojnë përgjegjësi prindërore të tyre, orarin javor të takimeve, të cilat kërkohen nga nxënës ose personat që ushtrojnë përgjegjësi prindërore të tyre, si dhe kalendarin e takimeve me ta.”

Neni 44, aspektet e zbatimit të kurrikulës, parashikon se: “1. Drejtori ka përgjegjësi për zbatimin e dokumenteve kurrikulave të miratuara nga ministri përgjegjës për arsimin. 2. Drejtori ka për detyrë të organizojë periodikisht analizën e gjendjes reale të rezultateve të nxënësve për çdo periudhë dhe në fund të vitit shkollor. 3. Drejtori drejton hartimin e planit që përcakton mënyra konkrete për përmirësimin e rezultateve të nxënësve me nevoja të veçanta. Ky plan zbatimi i tij janë objekt monnitorimi dhe vlerësimi nga strukturat përkatëse. Drejtoria ka përgjegjësi: a) për zhvillimin cilësor të kurrikulës në bazë shkolle; b) për përmbushjen e pëlqimeve të nxënësve për lëndët me zgjedhje. 5. Drejtori në bashkëpunim me këshillin e mësuesve, shqyrton rregullisht mbingarkesën e mundshme të nxënësve. 6. Drejtori merr nisma dhe nxit e mbështet zbatimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në administrimin e manaxhimit të institucionit dhe në zhvillimin e kurrikulës. 7. Drejtori lejon të përdoren nga nxënësit e IA vetëm botime ndihmëse dhe materiale të tjera mësimore, të miratuara nga ministri përgjegjës për arsimin nëpërmjet udhëzimeve të tij. 8. Institucioni arsimor ka të drejtë të aplikojë në strukturat përkatëse arsimore për pjesëmarrje në kërkimet shkencore dhe eksperimenteve. 9. Drejtori nuk ka të drejtë të ngarkojë mësuesit me detyra shtesë, të cilat nuk rrjedhin drejtpërdrejt nga zbatimi i legjislacionit arsimor në fuqi.”

Për sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se:

- *Nxënësi O. H, djali i ankuesit M. H, është trajtuar në mënyrë të diferencuar, të padrejtë, të pafavorshme krahasuar edhe me nxënësit tjerë me AK, duke e ngelur në klasë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për nxënësit me aftësi të kufizuara.*
- *Komisioneri vlerëson që nxënësi O. H. ishte në vijimësi dhe nuk mund të diskutohej më regjistrimi i tij në këtë gjimnaz, pasi ishte e njëjta situatë si një vit më parë, arsytim i cili u mbështet gjatë procedurës hetimore dhe nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë.*
- *Gjimnazi, nuk ka marrë asnjë masë paraprake për të diskutuar apo dhënë zgjidhje situatës së krijuar, por ka vendosur ndërprerjen e arsimit për nxënësin O. H, në kundërshtim me parashikimet ligjore për arsimin parauniversitar.*

Për sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se O. H, djali i ankuesit M. H, si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë dhe Gjimnazit "Aleks Buda" Tiranë, është vendosur në pozita të pafavorshme duke rezultuar ngelës si dhe duke iu refuzuar regjistrimi në klasën e X (dhjetë), pranë Gjimnazit "Aleks Buda", për vitin shkollor 2023-2024, edhe pse ishte nxënës i shkollës.

B. Shkaku i mbrojtur.

Ligji Nr. 10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", i ndryshuar, rregullon në mënyrë të drejtëpërdrejtë zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar, të pretenduar nga ankuesi si shkak diskriminues, duke parashikuar në nenin 1, të tij se : "Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër."

Në ankesën e depozituar ankuesi pretendon diskriminimin e djalit të tij O. H, për shkak të aftësisë së kufizuar. Referuar Planit të Edukimit Individual (PEI) të vënë në dispozicion nga ana e Gjimnazit "Aleks Buda", nxënësi O. H është vlerësuar si person me aftësi të kufizuar, diagnostifikuar me sindromën down dhe prapambetje mendore.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson të provuar faktin se nxënësi O. H, përfaqësuar në këtë proces nga z. M. H, babai i ankuesit, mbart shkaku e pretenduar të diskriminimit, atë të aftësisë së kufizuar.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë me shkaku e mbrojtur.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 57 të Kushtetutës sipas të cilit *“Kushdo ka të drejtën për arsimim”*. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”* (shih vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, të Gjykatës Kushtetuese)

E drejta për arsim, është një e drejtë kushtetuese, e cila duhet të sigurohet mbi baza të barabarta dhe pa diskriminim. E drejta për arsim garantohet edhe në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat vendi ynë i ka ratifikuar duke u bërë kështu pjesë e sistemit të brendshëm ligjor dhe të detyrueshme për t’u zbatuar.

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara, ndërkohë që Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me *“gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji”* dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se *“diskriminimi”* do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme.

Në nenin 3, pika 1 të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.”* Ky ligj parashikon disa forma nëpërmjet të cilave mund të shfaqet sjellja diskriminuese, duke përcaktuar në nenin 3, pika 2, se: *“2. “Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen*

në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.”. dhe pika 7: “Diskriminim i tërthortë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter ose praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte më pak të favorshme për shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji në raport me një tjetër person ose grup personash, kur ajo dispozitë, kriter a praktikë nuk justifikohet objektivisht nga 3 një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e arsimit gëzon një mbrojtje të veçantë sipas ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në nenin 17/1ç, 17/2 dhe 17/4, të këtij ligji, përcaktohet: “1. Ndalohet çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ç) trajtimin e studentëve ose nxënësve, duke përfshirë pranimin, vlerësimin, zbatimin e masave disiplinore ose përjashtimin e tyre. 2. Ndalohet t’i refuzohet një personi ose një grupi personash pranimi në një institucion arsimor publik, për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji...4. Zbatimi i masave të posaçme dhe të përkohshme, bazuar në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, me qëllim përshpejtimin e barazisë në arsim, nuk konsiderohet diskriminim. Zbatimi i masave të tilla, në asnjë rast, nuk mund të nënkuptojë mbajtjen e përhershme të standardeve të pabarabarta ose të ndryshme dhe këto masa ndërpriten kur arrihet objektivi i trajtimit dhe ofrimit të mundësive të barabarta...”.

Në bazë të nenit 5, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet: “1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Në bazë të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”.

Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”¹ (KDPAK), e cila përbën standartin më të lartë të mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, pranon diversitetin e personave me aftësi të kufizuara. Konventa ka pranuar se, aftësia e kufizuar, është një

¹Ratifikuar me ligjin nr. Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”.

koncept evolues dhe se aftësia e kufizuar, rezulton nga ndërveprimi ndërmjet personave me dëmtime dhe barrierave të qëndrimit/mentalitetit dhe ambientit, që pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në nivel të barabartë me të tjerët. Ky përcaktim synon gjithpërfshirjen dhe jo përjashtimin. KDPAK, ka sanksionuar vlerësimin e aftësisë së kufizuar bazuar në modelin bio-psiko-social, një qasje bazuar në të drejtat e njeriut, ndryshe nga modeli mjekësor, mbi bazën e të cilit është vlerësuar aftësia e kufizuar, deri para miratimit të kësaj Konvente. Konventa ka për qëllim të nxisë, të mbrojë dhe t'u sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre.

Sipas nenit 3, të KDPAK barazia dhe mosdiskriminimi, janë parime që përshkojnë të gjitha parashikimet e Konventës, por edhe e drejtë e veçantë, parashikuar nga neni 5, ku sanksionohet : *“1. Shtetet palë pranojnë se të gjithë personat janë të barabartë para ligjit dhe sipas ligjit dhe se kanë të drejtë pa asnjë diskriminim për mbrojtje të barabartë dhe përfitim të barabartë nga ligji. Shtetet palë duhet të ndalojnë çdo lloj diskriminimi me bazë aftësinë e kufizuar dhe t'u garantojnë personave me aftësi të kufizuara mbrojtje ligjore të barabartë dhe efektive ndaj çdo lloj diskriminimi në të gjitha situatat. 3. Me qëllim që të promovohet barazia dhe të eliminohet diskriminimi, shtetet palë duhet të ndërmarrin të gjithë hapat e duhur për të siguruar që është arritur akomodimi i arsyeshëm. 4. Masat specifike të cilat janë të nevojshme për të përshpejtuar apo arritur de facto barazinë e personave me aftësi të kufizuara nuk duhet të konsiderohen diskriminim sipas termave të kësaj konvente.”*

KDPAK ndalon çdo formë diskriminimi ndaj personave me aftësi të kufizuara. Ky parim ka të bëjë jo vetëm me mosdiskriminimin e personave me aftësi të kufizuar në raport me personat e tjerë, por edhe brenda kategorive të ndryshme të aftësisë së kufizuar. Konventa në mënyrë të posaçme në nenin 4/1, ka përcaktuar se: *“Shtetet Palë marrin përsipër të sigurojnë dhe promovojnë realizimin e plotë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të gjithë personat me aftësi të kufizuar pa diskriminim të ndonjë lloji me bazë aftësinë e kufizuar.”*

Në frymën e Konventës, është miratuar, Ligji nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”*, që ka si qëllim, të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes; të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre, të barabartë në shoqëri.

Persona me aftësi të kufizuara, sipas këtij ligji, janë, individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme,

përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët. Në gërmën “b”, të pikës 2, të nenit 5, të Ligjit nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” parashikohet se: “Politikat shtetërore mbështetin personat me aftësi të kufizuara që të kenë akses në të gjitha sferat e jetës e, ndër të tjera, të kenë akses përkatësisht: b) në shkollat e zakonshme dhe të studiojnë në shkollën për të cilën të dëshirojnë...”.

Ligji nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i cili ka si qëllim garantimin e të drejtës kushtetuese për arsimim, sanksionon se, e drejta për arsimim garantohej pa u diskriminuar. Çdo nxënës duhet t’i sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim, pavarësisht nga vendi ku ai banon apo ndjek shkollën.

Lidhur me arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor parauniversitar, legjislacioni shqiptar, në nenin 64/3 të Ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton si detyrim ligjor që institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, të krijojë një komision multidisiplinor, të përbërë nga mjekë, psikologë, mësues dhe specialistë për fëmijët me aftësi të kufizuara, i cili, vlerëson fëmijët me aftësi të kufizuara dhe jep rekomandimet përkatëse për ndjekjen nga fëmija të një institucioni arsimor të zakonshëm a të specializuar. Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet e arsimit special për ta është përgjithësisht e përkohshme, përbën një nga parimet e arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, përcaktuar nga neni 63, i ligjit të sipërcituar. Gjithashtu, referuar parashikimit të nenit 65, pika 3, të Ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nxënësve me aftësi të kufizuara u sigurohen dhe mësues ndihmës, sipas kriterëve të përcaktuara me udhëzim të ministrit.

Barra e provës në çështjet e diskriminimit rregullohet nga neni 33, pika 7/1 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se : “7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.”

Sa më sipër, ankuesi duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek pala e akuzuar, e cila duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuuese nuk është në gjendje të provojnë njëherë nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin².

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar, është shkaku i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër. Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës. GJEDNJ pranon si fakte ato vlerësime “*të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave...provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht*³”.

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezulton se nxënësi O. H, djali i ankuesit, i është nënshtruar një një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, duke u ngelur në klasë në kundërshtim me parashikimet ligjore në fuqi që rregullojnë arsimimin e nxënësve me aftësi të kufizuar në arsimin parauniversitar dhe si pasojë i është refuzuar vazhdimi i klasës e X (dhjetë), pranë Gjimnazit “Aleks Buda”, për vitin shkollor 2023-2024. Rezulton gjithashtu e provuar si nga përgjigjet e Gjimnazit, por dhe të shprehura nga znj.V. B, që arsyeja e mosregjistrimi në klasën e X (dhjetë) (*nxënës i cili ishte i regjistruar*), është mosha e nxënësit, qëndrim i cili u vlerësua i padrejtë si nga MAS dhe ZVAP Tiranë.

Komisioneri gjatë shqyrtimit të ankesës konstatoi:

- Nxënësi O. H, djali i ankuesit M. H, është trajtuar në mënyrë të diferencuar, të padrejtë, të pafavorshme krahasuar edhe me nxënësit tjerë me AK, duke e ngelur në klasë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për nxënësit me aftësi të kufizuar.
- Nxënësi O. H, ishte në vijimësi dhe nuk mund të diskutohej më regjistrimi i tij në këtë Gjimnaz, pasi ishte e njëjta situatë si një vit më parë, arsyetim i cili u mbështet gjatë procedurës hetimore dhe nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë.
- Gjimnazi, nuk ka marrë asnjë masë paraprake për të diskutuar apo dhënë zgjidhje situatës së krijuar, por ka vendosur ndërprerjen e arsimit për nxënësin O. H, në kundërshtim me parashikimet ligjore për arsimin parauniversitar.

²https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-laë-2018_en.pdf, fq.232.

³ GJEDNJ, *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë* (GC) paragrafi 147, (ECtHR, *Nachova and others v. Bulgaria* [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005). Kjo përsëritet në çështjen e GJEDNJ-së, *Timishev kundër Rusisë* (Numrat 55762/00 dhe 55974/00), 13 Dhjetor 2005, paragrafi 39 (ECtHR, *Timishev v. Russia* (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005), dhe GJEDNJ, *D.H dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13 Nëntor 2007, paragrafi 178 (ECtHR, *D.H. and others v. the Czech Republic* [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007).

- Zyra Vendore e Arsimit Tiranë, nuk rezulton që të ketë dërguar dosjen e plotë me rekomandimet konkrete në lidhje me nxënësin O. H, nuk rezulton të ketë përdorur të gjithë mekanizmat dhe kapacitetet e saja për të ndjekur, identifikuar por dhe kontribuar më shumë në lidhje me nxënësit me AK, që situata të tilla mos të përsëriten.
- Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë, nuk ka rishikuar në mënyrë periodike nëpërmjet strukturave të saj, secilin rast të personave me AK në shkollat respektive, dhe rast pas rasti të propozojë masa konkrete sipas nevojave të këtyre personave.

Ndërkohë, për arsye të mënyrës se si është vepruar nga ana e Gjimnazit në lidhje me rastin e nxënësit O. H, gjatë vitit mësimor 2022 - 2023, nga DRAP Durrës, me Vendimin nr. 23/2023 datë 31.10.2023, është vendosur: *“Të jepet masë disiplinore “Vërejtje” për drejtoren e Gjimnazit “Aleks Buda”, Tiranë, znj. V. B”*, por që pavarësisht këtij fakti në vlerësim të Komisionerit përgjegjësia sa i takon rastit objekt shqyrtimi është dhe e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë, e cila nuk e ka monitoruar rastin dhe nuk ka patur një bashkëpunim efektiv institucional me Gjimnazin “Aleks Buda” për trajtimin e këtij rasti, situatë e cila mund të ishte shmangur nëse ky institucion do të kishte zbatuar detyrimet ligjore që ZVAP-ja ka sipas nenit 80 dhe 81 të Rregullores *“Për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”*, miratuar nga MASR me Urdhërin Nr. 31, datë 28.01.2020.

Komisioneri konstaton se, në rastin objekt shqyrtimi, trajtimi i padrejtë, i pafavorshëm dhe i pabarabartë të cilit i është nënshtruar nxënësi O. H, është pasojë e drejtpërdrejtë e faktit që ai është person me aftësi të kufizuar.

Bazuar në aktet e administruara dhe konstatimet e mësipërme, Komisioneri vlerëson se, në pamje të parë, pra *prima facie*, faktet dhe provat e administruara krijojnë prezumimin se, nxënësi O. H, i është nënshtruar një trajtimi më pak të favorshëm, për shkak se është person me aftësi të kufizuara.

Gjimnazi “Aleks Buda” Tiranë, ka argumentuar se nxënësi O. H, është refuzuar për t’u rregjistruar në klasën e X (dhjetë), për vitin shkollor 2023-2024, për shkak se ka mbushur moshën 18 vjeç, duke ju referuar parashikimeve të Ligjit 69/2012 *“Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*, të ndryshuar.

Ndërkohë sqarojmë që nxënësi O. H, ka qenë i regjistruar në këtë Gjimnaz për vitin shkollor 2022-2023, në bazë të shkresës nr.8762 prot., datë 15.09.2022 të Zyrës Arsimore Shkodër, ku ndër të tjera është cituar se: *“Ky nxënës përbën një rast përjashtimor dhe me prioritet edhe pse ka tejkaluar moshën e përcaktuar në LAPU, pasi është me aftësi të kufizuar (Sidroma down). Mbështetur në orientimin e MAS për rastin, si dhe referuar të drejtave të përcaktuara me ligj dhe akte ndërkombëtare, nxënësit me aftësi të kufizuara referuar edhe përcaktimeve që jep Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, të mos i privohet e drejta për arsimim në institucionin arsimor, të cilin ai e ka zgjedhur si më të përshtatshëm. ZVA aprovon regjistrimin në klasën e*

dhjetë me kohë të plotë të këtij nxënësi për mos i sjellë vështirësi të tjera të gjendjes së tij shëndetësore dhe psikologjike.

Referuar parashikimeve specifike në legjislacionin ndërkombëtar të ratifikuar nga Shqipëria, legjislacionin e brendshëm, si dhe standardet ndërkombëtare dhe kombëtare barazia dhe mosdiskriminimi i personave me aftësi të kufizuara, duhet kuptuar jo vetëm midis personave me aftësi të kufizuara dhe personave të tjerë, por dhe midis llojeve e kategorive të ndryshme të aftësisë së kufizuar.

Sipas KEDNJ⁴-së, një shtet mund t'u nënshtrohet detyrimeve pozitive. Praktika relevante e GJEDNJ⁵-së për veprimet pozitive kryesisht i kushtohet çështjes nëse në situata të caktuara shteti është i detyruar, dhe jo vetëm i lejuar, të ndërmarrë veprime pozitive⁶.

Neni 11, i LMD-së ka parashikuar dhe mundësinë e ndërmarrjes së një sërë masash pozitive, duke sanksionuar se: *“Masa e përkohshme, e veçantë që synon përsheptimin e vendosjes reale të barazisë, kur mungesa e barazisë është shkaktuar nga diskriminimi për çdo shkak të përmendur në nenin 1, të këtij ligji, konsiderohet veprim pozitiv dhe nuk përbën diskriminim, sipas këtij ligji. Kjo masë ndërpritet sapo të jenë arritur objektivat e trajtimit dhe ofrimit të mundësive të barabarta.*

Në kushtet kur mungesa e arsimit për kategoritë vulnerabël, është një nga faktorët që ndikon në mosintegrimin e këtyre komuniteteve në shoqëri, institucionet publike arsimore dhe sidomos institucionet të cilët nëpërmjet politikave mbështetëse për nxitjen e arsimit duhet të tregohen më të hapur dhe të predispozuar në arsimimin e qytetarëve që i përkasin këtyre komuniteteve. Mundësia dhe politikat për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara, ndikojnë drejtpërdrejtë në jetën e komuniteteve të tyre dhe ndihmon në përsheptimin e integritit të tyre shoqëror e kulturor në shoqërinë shqiptare.

Lejueshmëria e marrjes së masave pozitive në favor të grupeve të pafavorizuara përforcohet më tej nga udhëzimet e lëshuara nga disa prej organeve monitoruese përgjegjëse për interpretimin e traktateve të të drejtave të njeriut të OKB-së. Këto organe kanë theksuar që masat e tilla duhet të jenë të përkohshme në natyrë, dhe jo të shtrihen në kohë apo hapësirë përtej asaj që është e nevojshme për të adresuar pabarazinë në fjalë.⁷ Sipas Komitetit të OKB-së për Eliminimin e Diskriminimit Racor, në mënyrë që të jenë të lejueshme këto masa duhet të kenë si qëllim vetëm eliminimin e pabarazive ekzistuese dhe parandalimin e disbalancave të ardhshme.⁸ Komisioni i OKB-së për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave thekson se *'masa speciale të përkohshme'*

⁴ Shkurtesë: Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

⁵ Shkurtesë: Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut

⁶ Handbook on European non-discrimination law, 2018, faqe 77.

⁷ Handbook on European non-discrimination law fq.38

⁸ UN Committee on the Elimination of Racial Discrimination, 'General Recommendation No. 32: The Meaning and Scope of Special Measures in the International Convention on the Elimination of All Forms of Racial Discrimination' UN Doc. CERD/C/GC/32, 24 September 2009, paras. 21-26.

mund të përfshijnë "trajtim preferencial; rekrutimin, punësimin dhe promovimin; qëllimet numerike të lidhura me kornizat kohore; dhe sistemet e kuotave".⁹

Gjykatat kanë tentuar të trajtojnë diskriminimin në këtë kontekst jo si një formë e veçantë e diskriminimit në vetvete, por si një përjashtim nga ndalimi i diskriminimit. Me fjalë të tjera, gjykatat pranojnë se ka ndodhur trajtimi i ndryshëm, por që mund të justifikohet në interes të korigjimit të një disavantazh të mëparshëm, siç është nën-përfaqësimi në vendin e punës të grupeve të veçanta.¹⁰

Në çështjen *Ponomaryovi v. Bullgarisë* (Nr. 5335/05), 21 qershor 2011, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka cituar ndër të tjera se: "...arsimimi është një e drejtë që gëzon mbrojtjen e drejtpërdrejtë të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Gjithashtu arsimit është një lloj tejet i veçantë i shërbimeve publike, që jo vetëm u sjell përfitime atyre që e përdornin atë, por që ka, po ashtu, edhe një funksion më të gjerë shoqëror dhe ishte i pazëvendësueshëm për të çuar më tej të drejtat e njeriut.

Në çështjen *Thlimmenos kundër Greqisë*¹¹, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka mbajtur qëndrimin se: "...kemi një diskriminim kur shteti pa një argumentim objektiv dhe racional e refuzon trajtimin e diferencuar të personave, situata e të cilëve është tepër e ndryshme...".

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016-2020¹², citon ndër të tjera se:

"...një theks të veçantë kanë politikat dhe masat konkrete për të realizuar një arsim gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara, pavarësisht nga lloji i aftësisë së kufizuar që ata kanë. Vizioni për vitin 2020 është që çdo fëmijë me Aftësi të Kufizuara të jetë përfshirë në arsimin bazë dhe numri i të rinjve me Aftësi të Kufizuara që ndjekin arsimin e mesëm dhe të lartë të jetë rritur.

Qëllimi i këtij Plani Veprimi të qeverisë është të nxisë përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në shoqërinë shqiptare, të parandalojë diskriminimin dhe t'u eliminojë pengesat për të pasur akses në shërbimet dhe të drejtat e tyre. Nëpërmjet zbatimit të tij, Qeveria e Shqipërisë do të përmirësojë aksesueshmërinë e informacionit dhe shërbimeve publike, do të lehtësojë arsimin gjithëpërfshirës, do të aplikojë një vlerësim të ri të aftësisë së kufizuar bazuar në modelin bio-psiko-social dhe do të zgjerojë shërbimet sociale me bazë në komunitet, shërbimet e rehabilitimit dhe masat për nxitjen e punësimit.

⁹ UN Committee on the Elimination of Discrimination Against Women, 'General Recommendation No. 25: Article 4, para. 1 of the Convention (temporary special measures)' UN Doc. A/59/38 (supp), 18 March 2004, para. 22.

¹⁰ Handbook on European non-discrimination law fq.38

¹¹ Thlimmenos kundër Greqisë, Kërkesa nr. 34369/97, vendimi me datë 06.04.2000.

¹² Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 483, datë 29.06.2016

Gjithashtu, Plani i Veprimit parashikon aktivitete që synojnë përmirësimin ose zgjerimin e programeve ekzistuese (siç janë arsimit dhe formimi profesional, punësimi, shërbimet sociale, programet gjithëpërfshirëse të arsimit, ndihma juridike falas, etj)...”.

Ndërsa, Plani i ri Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025¹³, citon ndër të tjera se:

“Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar (PKVPAK) 2021-2025, është një dokument ndërsektorial i qeverisë shqiptare që përfshin politika të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara e që do të hidhen për zbatim gjatë 5 vjecarit të ardhshëm. Qëllimi i tij është të vazhdojë promovimin dhe mbështetjen e integritit të personave me aftësi të kufizuara në jetën social-ekonomike të vendit duke patur në vëmendje të vazhdueshme përmbushjen e detyrimeve të KDPAK përmes masave specifike.

Procesi i hartimit të këtij dokumenti përputhet edhe me një moment tjetër të rëndësishëm të zbatimit të politikave për aftësinë e kufizuar në Shqipëri në funksion të realizimit të parimeve të KDPAK, të ratifikuar nga shteti shqiptar.

Sigurimi i arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës dhe i të mësuarit gjatë gjithë jetës për personat me aftësi të kufizuara është një ndër qëllimet politike të PKVPAK. Objektivat specifike në kuadër të këtij qëllimi, të parashikuara në këtë plan përcaktojnë: (i) Rritja e mundësive për pjesëmarrje në arsimin gjithëpërfshirës për fëmijët me lloje të ndryshme të AK-së; (ii) Shndërrimi i shkollave të specializuara në qendra burimore, duke përfshirë dhe mbështetur të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Politika orienton institucionet publike në masat që ato duhet të marrin për realizimin e aksesueshmërisë për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara në: (i) mjedise; (ii) transport; (iii) informacion e komunikim.

Sigurimi i një jete të pavarur për personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet: i. sigurimit të ofrimit të shërbimeve të integruara socioshëndetësore; ii. sigurimit të një jetese dinjitoze me anë të indeksimit të pagave, punësimit, rritjes së qasjes së tyre në transportin urban dhe ndërrurban, duke përmirësuar shërbimet dhe infrastrukturën e tij; iii. përfshirjes së tyre në sistemin arsimor publik.”.

Ky dokument thekson faktin se, qeveria është e angazhuar të administrojë në mënyrë aktive çështjen e aftësisë së kufizuar në Shqipëri duke përditësuar gjithmonë e më shumë të drejtat e PAK në politikat e saj sektoriale. Për arritjen e këtij qëllimi është e nevojshëm edhe mbështetja më e fuqishme në eliminimin e të gjitha barrierave dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor publik.

¹³ Miratuar me VKM nr. 276, datë 12.05.2021

Komisioneri konstaton se, Gjinnazi “Aleks Buda” Tiranë, së pari nuk duhet ta kishin ngelur nxënësin në klasë, e më pas të kishin refuzuar regjistrimin e nxënësit O. H, në klasën e X (dhjetë), si përsëritës, duke qenë se ai ishte nxënës i këtij gjinnazi dhe kishte ndjekur vitin shkollor 2022-2023.

Gjithashtu Komisioneri konstaton që në vlerësimin e tre mujorit të fundit Komisioni i IA ndër të tjera ka rekomanduar: *1) Që nxënësi të frekuentojë shkollën është e domosdoshme trajtimi i nxënësit me planin PEI edhe në vitin e ardhshëm dhe vendosja e objektivave minimale duke i përshtatur me ritmet e zhvillimit të tij dhe mundësitë që ai ka. 2) Të analizohet fakti nëse nxënësi me AK mund të përballojë frekuentimin e shkollës prej një harku kohor katër orë në ditë, referuar mundësive të tij.* Ky komision ka tagrin për të vlerësuar nëse nxënësi me aftësi të kufizuar është i aftë për të vijuar arsimin në atë institucion por dhe të rekomandojë një institucion tjetër arsimor në përshtatje me nevojat e tija, (me miratimin e prindërit), por që në rastin konkret nuk është sugjeruar diçka e tillë.

Fakti që Gjinnazi, nuk ka patur në vëmendje interesin më të lartë të nxënësit dhe detyrimet që qeveria shqiptare është e angazhuar në eliminimin e të gjitha barrierave dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor publik, ka vendosur në kushte të diskriminuese nxënësin O. H, për shkak të aftësisë së kufizuar, duke i mohuar të drejtën për arsim, nxënësit i është refuzuar e drejta për regjistrimin në gjinnaz, atij nuk i është ofruar asnjë alternativë tjetër, e parashikuar në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, por thjesht nga ana e Gjinnazit është kthyer përgjigje që pranimi i tij nuk mund të bëhet për arsye të moshës së tij mbi 18 vjeç.

Në përfundim, Komisioneri vlerësoi në tërësi se, ngelja në klasë e nxënësit me aftësi të kufizuar si dhe refuzimi për të regjistruar nxënësin O. H, në klasën e X (dhjetë) nga ana e Gjinnazit “Aleks Buda”, nuk është një veprim i mbështetur në një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Gjithashtu Komisioneri arrin në përfundimin se pavarësisht se ZVAP Tiranë, ka ndërmarrë disa veprime pasi janë njohur me situatën e nxënësit O. H, nuk i përjashton ata nga përgjegjësia e tyre, pasi rezulton që në zbatim të detyrimeve ligjore që ZVAP-ja ka sipas nenit 80 dhe 81 të Rregullores “Për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, miratuar nga MAS me Urdhërin Nr. 31, datë 28.01.2020, duhet të përcillte pranë Gjinnazit:

- a. Vendimin e komisionit multidisiplinar për nxënësin O. H, në të cilin të ishin përcaktuar qartë nevojat arsimore të këtij nxënësi, rekomandimet për planin mësimor dhe programet lëndore.
- b. Të ndiqte ecurinë e nxënësve me AK përgjatë gjithë vitit, përveç dokumentacionit të gjendjes fillestare të nxënësit me AK, të përditësonte ecurinë e tyre, në bashkëpunim me komisionin e IA.
- c. ZVA-ja nëpërmjet NjShPS-së, të bashkëpuntojë me mësuesit e shkollës për hartimin dhe vënien në jetë të planit edukativ individual për këta nxënës.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstaton se Gjimnazi “Aleks Buda”, Tiranë dhe Zyra Vendore e Arsimit Tiranë, me veprimet dhe mosveprimet e tyre, kanë diskriminuar nxënësin O. H, për shkak të aftësisë së kufizuar, në të drejtën e tij për t’u arsimuar.

Mungesa e bashkëpunimit e institucioneve, fakti që këto institucione nuk janë angazhuar maksimalisht për eliminimin e të gjitha barrierave që nxënësit me aftësi të kufizuar hasin në përditshmërinë e tyre por dhe më gjerë, sjellë si pasojë mospërfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor publik ose braktisjen e tij.

Në funksion të parandalimit në të ardhmen të situatave diskriminuese, Komisioneri thekson nevojën që Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë, të rishikojë në mënyrë periodike nëpërmjet strukturave të saj, secilin rast të personave me AK në shkollat respektive, dhe rast pas rasti të propozojë masa konkrete sipas nevojave të këtyre personave.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të LMD, përcaktohet se: *“Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”*, ndërsa bazuar në nenin 33, pika 12, të po këtij ligji, përcaktohet: *“Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”*. LMD, në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktimat të diskriminimit. LMD, nëpërmjet nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Pala ankuese ka kërkuar nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit të djalit të tij me aftësi të kufizuar O. H. Në lidhje me marrjen e masave për rregullimin e situatës, ankuesi nuk kërkoi që djali i tij të regjistrohej pranë Gjimnazit “Aleks Buda”, Tiranë, pasi ai kishte humbur besimin në lidhje me trajtimin e djalit të tij. Ankuesi kërkoi nga Komisioneri, marrjen e masave për të ndrequr situatën diskriminuese, nëpërmjet zbatimit të të drejtave të nxënësve me aftësi të kufizuara, trajtimin e këtyre nxënësve në shkollë njëlloj si të tjerët, dhe këta nxënës të mos ngelin në klasë.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, masa e duhur në mënyrë që situata të ngjashme diskriminuese të parandalohen dhe të mos përsëriten, është marrja e masave nga ana e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë dhe Gjimnazit “Aleks Buda”, Tiranë, që të ndalojnë dhe të mospërsërin në të ardhmen praktika të ngjashme me rastin e nxënësit O. H, si dhe të mbahet në vëmendje nga ana e tyre, mbështetja më e fuqishme në eliminimin e të gjitha barrierave dhe përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor publik.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të nxënësit O. H, në të drejtën për arsim, për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë dhe Gjimnazit “Aleks Buda” Tiranë.
2. Në referim të pikës 1, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë, të rishikojë në mënyrë periodike nëpërmjet strukturave të saj, secilin rast të nxënësve me aftësi të kufizuar në shkollat respektive, dhe rast pas rasti të propozojë masa konkrete sipas nevojave të këtyre personave sipas legjislacionit në fuqi.
3. Në referim të pikës 1, Gjimnazi “Aleks Buda”, Tiranë të marrë masa që të ndalojë dhe të mospërsërisë në të ardhmen praktika të ngjashme me rastin e nxënësit O. H.
4. Në referim të pikës 1, të këtij vendimi, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë dhe Gjimnazi “Aleks Buda” Tiranë, të marrin masa që në të ardhmen të mbahet në vëmendje nga ana e tyre, mbështetja më e fuqishme në eliminimin e të gjitha barrierave dhe përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor publik.
5. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë Vendim Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë dhe Gjimnazi “Aleks Buda” Tiranë, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
6. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
7. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Hartoi: L. Jani

Rishikoi: K. Kamberi
Miratoi: V. Bushati
Datë: 18.03.2024